01 06-3787/17
20.07.2017

**KOMUNA E KLINËS**

# STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK TE KOMUNËS SË KLINËS 2017-2021

**Qershor/ 2017**

## Fjala e Kryetarit



Të nderuar qytetarë të Komunës së Klinës. Kam nderin t'jua prezantoj Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal. Klina, viteve që shkuan, ka dhënë dëshmi për tejkalim të suksesshëm të fazës së investimeve emergjente.
Sfidat në procesin e zhvillimit jane të shumta, por mund të them me bindje të plotë që në te ardhmen , ***Komuna e Klinës do të jetë një nder komunat e zhvilluara dhe do te mund të ofrojë shanse reale për të jetuar dhe punuar për një jetesë me të mirë për ne dhe brezat e ardhshëm.***
Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal trason rrugën dhe veprimet drejt zhvillimit lokal dhe përmirësimit të kushteve të jetesës.Klina, duke zgjedhur këtë rrugë, po hyn në fazën e realizimeve të synimeve për një komunë me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, me urbanizim bashkëkohor, me perspektivë të zhvillimit të turizmit dhe jetës së begatë kulturore,arsimore dhe sportive, me mbështetje direkte të zhvillimit të bujqësisë e industrisë përpunuese, permes shtimit të investimeve dhe krijimit të një ambienti të përshtatshëm për punësim në këta sektorë.
Strategjia fuqizon ngritjen e kapaciteteve qeverisëse duke përmirësuar zbatimin e ligjeve, fuqizon komunitetin duke krijuar klimë partneriteti me biznesin,shoqërinë civile e qytetarët, e cila do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësim të qeverisjes lokale e rrjedhimisht edhe përdorim efektiv të aseteve komunale. Ky dokument strategjik po i përcakton mekanizmat për ta bërë realitet vizionin tonë për një komunë me rritje më të lartë ekonomike dhe nivel më të ulët të papunësisë , me administratë moderne dhe arsim të nivelit evropian. Dokumenti strategjik synon të ndërtojë një baraspeshë zhvillimore në aspektin e hapësirës, të zhvillimit dhe progresit harmonik ambiental por edhe social.
Strategjia Komunale për Zhvillim Ekonomik, e punuar me përkushtim nga grupi punues i komunës, është imperativ kohor dhe përshtatje e dinamikës së zhvillimit që mekanizmat institucionalë lokalë të jenë urë lidhëse mes qytetarëve dhe pushtetit vendor, mes biznesit dhe pushtetit lokal,mes bujkut e pushtetit lokal, mes prodhuesit e pushtetit.
Komuna e Klinës me këtë dokument po shpreh vullnetin për të progresuar karshi mundësive dhe potencialeve që ka. Në emër të qytetarëve të Komunës së Klinës falënderoj kontribuesit gjatë hartimit të kësaj strategjie, duke ju ftuar të gjithëve që këtë dokument strategjik zhvillimor ta konceptojmë si një vlerë të përbashkët, e cila do të rrisë cilësinë e jetës së tanishme dhe të asaj të ardhme për të gjithë.

**Sokol Bashota,kryetar**

**” Ndërtojmë së bashku një komunë të begatë”**

# PËRMBAJTJA

HYRJA....5
KORNIZA DHE BAZA LIGJORE PËR STRATEGJINË E ZHEL-it, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KUVENDIT KOMUNAL....6
I.ORGANIZIMI I PËRPJEKJEVE....7
BUXHETI I KOMUNËS....8

II. VLERËSIMI I GJENDJËS EKZISTUESE....9
Historik i shkurtër i komunës se Klinës....9
Pozita gjeografike e Klinës....11
Popullësia....14
Popullsia e Komunës së Klinës sipas vendbanimit,gjinisë dhe etnicitetit....15
Vlerësimet e numrit të popullësisë në vitin 2014....16
Të dhëna demografike dhe pronësore të ekonomive familjare në Komunën e Klinës....17
Numri i nxënësve , shkollave dhe personelit arsimor në shkollat e Komunës së Klinës në vitin shkollor 2015-2016....18
Arsimi parashkollor dhe parafillor ( mosha 0-6 vjeçar)....18
Arsimi fillor dhe i mesëm i ultë publik ( klasa 1-9 )....18
Arsimi i mesëm i lartë publik dhe privat ( klasa 10-12 )....19
Gjendja ekzistuese në shëndetësi-Infrastruktura ekzistuese shëndetësore (njerëzore dhe fizike)....19
Gjendja ekzistuese në lëminë kulturës,rinisë dhe sportit....20

Gjendja ekzistuese në lëminë e trashëgimisë kulturore....21

Gjendja sa i përket punësimit dhe papunësia....21
Pasuritë (resurset) natyrore....24
Pasuritë (resurset) turstike....24
Gjendja ekzistuese ekonomike,numri dhe sruktura e Ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme....25
Gjendja ekzistuese e zhvillimit të bujqësisë....26
Gjendja ekzistuese e infrastrukturës fizike....27

III. SWOT ANALIZA....29
IV. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2017-2021....31
Vizioni i integruar për Komunen e klinës....31

Zhvillimi i integruar ekonomik i Komunës së Klinës – problemet dhe sfidat e identifikuara zhvillimore....32
Synimet për zhvillim të integruar ekonomik të Komunës së Klinës....32
1. Zhvillimi ekonomik....33
Ndërmarrësia-Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme....34
Zhvillimi i bujqësisë....36
Zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore....38
2. Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve....39
3. Përmirësimi i cilësisë se arsimit dhe shëndetësisë....40
4. Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor....42

PRIORITETET E IDENTIFIKUARA DHE OBJEKTIVAT E SHOQËRISË CIVILE SA I PËRKET INFRASTRUKTURËS FIZIKE / LIGJORE....42
REZULTATET DHE EFEKTET QË PRITEN NGA ZBATIMI I STRATEGJISË SË ZHEL-it.... 43
PROJEKTET QË SYNOHET TË REALIZOHEN GJATË PERIUDHËS 2017-2021....44
V. AMZA : NGA VIZIONI DERI TË PROJEKTET....48

# HYRJA

Me qëllim të krijimit të parakushteve për zhvillim ekonomik lokal, të planifikuar dhe të sinkronizuar e në bazë të përgjegjësisë që ka Komuna e Klinës vendosi të hartojë Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhën 2017-2021.

Hartimi i strategjisë fillon me analizën e gjendjes, pra duke u përgjigjur në pyetjen se ku gjendet Komuna e Klinës tani, pastaj përcakton synimet se ku dëshiron të arrijë Komuna në vitin 2021 dhe si do të arrijë deri në atë pikë të dëshiruar të zhvillimit ekonomik lokal. Ky dokument jo vetëm që përvijon caqet e ardhshme të zhvillimit por ofron edhe mënyrën e organizimit sa më të mirë të potencialeve dhe burimeve ekzistuese si dhe mobilizimin e tyre drejt një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës.

Zhvillimi Ekonomik Lokal (ZHEL) bashkëkohor është një proces ku partneriteti mes sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile është vendimtar në ngritjen e mirëqenies. Përmirësimi i ambientit për bizneset është pikë kthese në zhvillimet pozitive. Ne, shpresojmë se pikërisht ky dokument do të nxis një zhvillim më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm të Komunës sonë, duke krijuar një ambient më të favorshëm për biznese dhe për tërheqjen e investitorëve të rinj.

Strategjia është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin e biznesit, shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e komunitetit. Prandaj, konsiderojmë se ky dokument do të stimulojë krijimin e partneriteteve midis sektorit publik dhe privat, por edhe me shoqërinë civile dhe qytetarët në implementimin e projekteve të identifikuara me këtë strategji.

Qëllimi i kësaj strategjie është që të krijoj një udhëzues të adresuar autoriteteve komunale për pengesat e zhvillimit ekonomik lokal, si dhe të gjej politikat më progresive që të shfrytëzoj resurset dhe mundesitë me qëllim të përmirësimit të zhvillimit ekonomik lokal dhe standardit jetësor të qytetarve .

Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit ekonomik lokal për periudhen 2017-2021 do të kaloj këto faza :

- Organizimi i aktiviteteve dhe përpjekjeve,
- Analiza e gjendjës ekzistuese dhe vlerësimi konkurues ( SËOT- analiza ),
- Hartimi dhe aprovimi i Strategjisë së Zhvillimit ekonomik lokal ,
- Zbatimi (implementimi ) i Strategjisë ,
- Rishqyrtrimi, vlerësimi dhe monitorimi i Strategjisë .

# KORNIZA DHE BAZA LIGJORE PËR STRATEGJINË E ZHEL-it, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KUVENDIT KOMUNAL

Si çdo dokument publik dhe zyrtar edhe Strategjia e ZHEL-it qe në fillim perveq qëllimit dhe arsyes se punimit dhe hartimit të saj ajo e ka edhe bazën juridike dhe ligjore mbi të cilën mbeshtetet.
Mbeshtetja dhe baza kryesore ligjore e Strategjisë se ZHEL-it është në legjislacionin primar dhe ai në rend të parë është:

1. Ligji për Vetë qeverisjën Lokale, nr.03/L-040 („Flet. Zyr. e Kosovës„ nr.28 dt.04.06.2008),
2. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-049 („Flet. Zyr. e Kosovës„ nr. 27 dt.03.06.2008),
3. Ligji për Kufijt Administrativ të Komunave, nr.03/L-041 („Flet. Zyr. e Kosovës„ nr.26 dt.02.06.2008), si dhe se fundmi edhe akti nenëligjor i komunës,
4. Statuti i Komunës se Klinës, i miratuar më dt.31 mars 2010.

Përveq legjislacionit primar Strategjia e ZHEL-it bazohet edhe në frymën e dispozitave të legjislacionit tjetër të cilat ligje kan interferim në një mënyrë apo tjetër në përmbajtjën e Strategjisë se ZHEL-it sidomos në përmbajtjën e politikave sektoriale si pjesë përbërse e strategjisë. Në ketë sens juridik legjislacioni në fuqi i cili në një mënyrë apo tjetër ka përligjur çeshtjet sektoriale si pjesë e strategjisë, është:

1. Ligji për Planifikimin Hapsinor nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013,
2. Ligji për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit , nr.03/L-048 dt. 13.03.2008 me të gjitha plotësimet dhe ndryshimet e tija të më vonëshme,
3. Ligji për Investimet e Huaja nr.04/L-220 dt.12.12.2013,
4. Ligji për Ndërtimin, nr.04/L-110 dt.31.05.2012, si dhe
5. Ligjet e tjera sektoriale nga lëmija e: Ekonomisë, Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Shendetësisë, Arsimit, Kulturës, Sportit dhe Turizimit, si dhe të Infrastrukturës dhe të gjitha degve të saja dhe Mjedisit Jetësorë e po ashtu edhe të Telekomunikacionit dhe Energjisë.

Kuvendi i Komunës së Klinës është organi më i lartë legjislativ në Komunë, i cili zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët, në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet Lokale.
Kuvendi i Komunës së Klinës ka 27 anëtarë, 2 komitetetë përhershme, 5 komitete tjera dhe 2 komitete konsultative.

**Komitetet e përhershme janë:**

- Komiteti për politikë dhe financa
- Komiteti për komunitete

**Komitetet tjera janë :**

- Komiteti për shendetësi dhe mirëqenje sociale
- Komiteti për Arsim, kultur, rini dhe sport

- Komiteti për zhvillim ekonomik,planifikim urban,kadaster dhe mbrojtje të mjedisit
-Komiteti për auditim te brendshëm
- Komiteti për shërbime publike
- Komiteti për pronë

**Komitete konsultative janë:**

- Komiteti për menagjimin e rasteve emergjente
- Komiteti për bujqësi dhe zhvillim rural

Administrata komunale e Komunës së Klinës është e organizuar në 10 drejtori,të cilat menaxhohen nga drejtorët komunal në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi ,si :

1. Drjetoria e Administratës,
2. Drejtoria e Shendetësisë dhe Mirëqënjes Sociale,
3. Drejtoria e Arsimit,
4. Drjetoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit,
5. Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjës se Mjedisit,
6. Drejtoria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural,
7. Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Emergjente,
8. Drejtoria e Inspektoriatit,
9. Drejtoria e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë, si dhe
10. Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

# I. ORGANIZIMI I PËRPJEKJEVE

Strategjia e ZHEL-it është një dokument publik dhe zyrtar i pushtetit lokal,një udhërrëfyes mbi kahet dhe synimet Zhvillimit ekonomik lokal duke krijuar kushtet për një rritje të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik të komunës së Klinës,rritjes se shkallës se punësimit dhe përdorimit të resurseve të disponueshme natyrore,njerëzore me qëllim përfundimtar rritjen e mirëqenjes se përgjithshme të qytetarëve të komunës dhe për zhvillim të drejte dhe të barabartë të të gjitha lokaliteteve dhe fshatrave të komunës.

Komuna e Klinës ka treguar interesim dhe motivim për hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik të Komuns për periudhën 2017 – 2021. Me një mbështetje të plotë të Kryetarit të Komunës, z. Sokol Bashota, dhe me angazhimin e drejtorëve të Drejtorive të Administratës Komunale , janë krijuar kushtet e nevojshme për zhvillimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm për Komunën.

Së pari është organizuar takimi i përbashkët i udhëheqësisë komunale me drejtorët e drejtorive komunale , në të cilin takim është formuar grupi punues për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit ekonomik të Komunës së Klinës për 2017-2021.
Më pas është organizuar takimi i Grupit punues me përfaqësues biznesesh dhe OJQ –ve.

**Grupi punues**

Sokol Bashota - Kryetar i Komunës së Klinës, udhëheqës i ekipit realizues
Ramiz Rrusta - Drejtor i Drejtorisë për Financa , Ekonomi dhe Zhvillim
Enver Marmullaku - Drejtor i Drejtorisë për Bujqesi
Hajdin Morina - Drejtor për Arsim
Bedri Gashi - Drejtor për Shëndetësi dhe mirëqenje sociale
Enver Berisha - Nenkryetar i Komunës së Klinës
Xufe Kelmendi - Zyrtare kryesore financiare
Millorad Sharkoviq – Zyra lokale për komunitete
Aziz Desku - Ecc. i dip – përfaqësues i bizneseve si dhe në bashkpunim me përfaqësues të shoqerisë civile :

Elbasan Racaj - OJQ – " KOHA " dhe
Tahire Gashi - OJQ – " ZANA "

Pas themelimit te Grupit punues dhe organizimit te takimit të parë të këtij ,përgjegjësitë për hartimin e Strategjisë se Zhvillimit ekonomik te komunës së Klinës janë bartur te Grupi punues i cili ka organizuar takime,konsulta dhe punëtori me palë të ndryshme të interesit dhe partneritet në mes të sektorit publik,sektorit privat ,shoqërisë civile si dhe njohës te lamive përkatëse që kanë të bëjnë me Zhvillimin ekonomik lokal .

## BUXHETI I KOMUNËS

Buxheti dhe financat komunale, në përgjithësi, rregullohen me Ligjin për financat e pushtetit lokal. Buxheti përbëhet prej të hyrave vetiake, grandeve nga qeveria, donacioneve dhe të hyrave të tjera, të paraqitura si në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 1: Struktura e buxhetit të Komunës së Klinës, për vitin fiskal: 2015, 2016, 2017, 2018, 2019**

| NR. | PËRSHKRIMI | 2015 BUXHETI | 2016 BUXHETI | 2017 PLANI | 2018 VLERËSIMI | 2019 VLERËSIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **TË HYRAT KOMUNALE TOTALE** | **8,346,381** | **8,333,886** | **8,645,555** | **8,852,109** | **9,026,990** |
| 1.1 | Grandet qeveritare | 7,488,614 | 7,305,886 | 7,615,034 | 7,821,588 | 7,983,424 |
| 1.2 | Të hyrat vetiake | 857,767 | 1,028,000 | 1,030,521 | 1,030,521 | 1,043,566 |
| 2 | **SHPENZIMET KOMUNALE TOTALE** | **8,346,381** | **8,333,886** | **8,645,555** | **8,852,109** | **9,026,990** |
| 2.1 | **Shpenzimet rrjedhëse** | **6,275,700** | **6,422,804** | **6,533,800** | **6,558,341** | **6,582,875** |
| 2.1.1 | Pagat dhe mëditjet | 5,419,700 | 5,592,191 | 5,656,411 | 5,682,742 | 5,707,275 |
| 2.1.2 | Mallrat dhe Shërbimet | 624,742 | 603,588 | 660,364 | 637,000 | 637,000 |
| 2.1.3 | Shpenzimet komunale | 151,258 | 161,258 | 151,258 | 161,000 | 161,000 |
| 2.1.4 | Subvencionet | 80,000 | 65,767 | 65,767 | 77,599 | 77,599 |
| 2.2 | **Shpenzimet kapitale** | **2,070,681** | **1,911,082** | **2,111,755** | **2,293,768** | **2,444,115** |

**Burimi: Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim**

Në veçanti, tabela tregon se buxheti i Komunës së Klinës është siguruar vetëm nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetiake, pa mbështetje të donacioneve.
Ky buxhet shpërndahet në shpenzimet operative dhe shpenzime kapitale, dhe në këtë rast shpenzimet operative financohen kryesisht nga grandet qeveritare, ndërsa shpenzimet kapitale financohen nga grandet dhe transferet e qeverisë, si dhe të hyrat vetiake.
Në shpenzime operative apo rrjedhëse hyjnë pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet. Ndërsa të hyrat vetiake të Komunës grumbullohen nga tatimi në pronë, taksat komunale për biznese, tarifat dhe ngarkesat tjera.
Në tabelën më poshtë është paraqitur pjesëmarrja në përqindje e grandeve qeveritare dhe të hyrave vetiake në të hyrat e përgjithshme komunale si dhe pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive.

**Tabela 2: Struktura e buxhetit të Komunës së Klinës, për vitin fiskal 2015, 2016, 2017, 2018, 2019**

| NR. | PËRSHKRIMI | 2015 AKTUALE | 2016 AKTUALE | 2017 PLANI | 2018 VLERËSIMI | 2019 VLERËSIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **TË HYRAT KOMUNALE TOTALE** | **8,346,381** | **8,333,886** | **8,645,555** | **8,852,109** | **9,026,990** |
| 1.1 | Grandet qeveritare | 89.72% | 87.66% | 88.08% | 88.36% | 88.44% |
| 1.2 | Të hyrat vetiake | 10.28% | 12.34% | 11.92% | 11.64% | 11.56% |
| 2 | **SHPENZIMET KOMUNALE TOTALE** | **8,346,381** | **8,333,886** | **8,645,555** | **8,852,109** | **9,026,990** |
| 2.1 | **Shpenzimet rrjedhëse** | **75.19%** | 77.07% | **75.57%** | **74.09** | **72.92%** |
| 2.1.1 | Pagat dhe mëditjet | 64.93 | 67.10% | 65.42% | 64.20 | 63.22% |
| 2.1.2 | Mallrat dhe Shërbimet | 7.49 | 7.24% | 7.64% | 7.20 | 7.06% |
| 2.1.3 | Shpenzimet komunale | 1.81 | 1.94% | 1.75% | 1.82 | 1.78% |
| 2.1.4 | Subvencionet | 0.96 | 0.79% | 0.76% | 0.87 | 0.86% |
| 2.2 | **Shpenzimet kapitale** | **24.81%** | **22.93%** | **24.43%** | **25.91** | **27.08%** |

**Burimi: Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim**

# II. VLERËSIMI I GJENDJËS EKZISTUESE

## Historik i shkurtër i komunës se Klinës

Në shek. e I të erës së re territori i Klinës si dhe i gjithë Dardanisë gjendej nën sundimin e Perandorisë Romake në ç'kohë në afërsi të Klinës përmendet Dersniku si qendër municipale e farefisit dardan. Pas rënies së Perandorisë Romake, Dardania, pra edhe Klina me rrethinë, u vërshua nga sllavët, e cila dyndje në gadishullin Ballkanik mori fund në shek. VIII. Pas ndarjes së Perandorisë Romake, Klina me rrethinë ra nën sundimin bizantin-grek. Pas krishterimit bizantin, ai sllav ndikoi që këto anë me vendbanimet mesjetare dhe me kishat parasllave të përvetësohen nga

sllavët. Në shekullin e parë të erës sonë, gjatë sundimit romak, si qendër municipale e fisit dardan përmendet edhe Dersniku, ndërsa gjatë sundimit bizantin hasim në gjurmët e kishës së Paskalicës me kambanore në fshatin Videjë.

Edhe Klina na del si vendbanim i hershëm ilir, me emër Chinna, të cilën e hasim te Ptolomeu që në vitet 87-150 (në hartën e Ptolomeut). Ky lokalitet i lashtë ilir shtrihej në bregun e majtë të rrjedhës së epërme të Drinit të Bardhë, që i përgjigjet realitetit të sotëm gjeografik. Kjo datë si dhe Ujëvara e Mirushës u bënë edhe simbol i Emblemës së qytetit të Klinës. Chinna në kuptimin Cin shpjegohet si kin në mes të Drinit të Bardhë dhe lumit Klina.

Profirogoniti në traktin e tij të njohur "Shënime për popujt" shkruan në vitin 948-952, se ndër qytetet e banuara dendur është edhe Dersniku - "Desstinik. Vendbanim i hershëm është edhe Dollci i sotëm, i cili ishte i shënuar me emrin Zalug në hartën e Manastirit të Hilandarit në vitin 1200 nga Solovjevi. Pas rënies nën turqit, jeta e shqiptarëve ishte e vështirë. Që prej atëherë Klinën e karakterizon edhe larmia fetare. Popullsia e këtyre trevave merrej kryesisht me bujqësi e cila ishte mjaft e zhvilluar.

Kohëve të fundit,në lokalitetin e Dresnikut janë bërë gjurmime dhe gërmime arkeologjike të cilat pritet të hedhin me shumë dritë mbi qytetërimin e hershëm të këtij lokaliteti të Dardanisë.

Për një periudhë pesëqind vjeqare Klina dhe Kosova ishte nën sundimin Otoman, kurse pas rënjes se Perandorisë osmane nga viti 1913 e deri në vitin 1999 Kosova ishte njësi konstituive e Federatës jugosllave dhe pjesë përbërëse e Serbisë-e aneksuar dhunshëm pa vullnetin dhe dëshirën e poullit të saj.

Komuna e Klinës si njësi organizative në kuadër të organizimit territorial të Republikës së Kosovës është themeluar në rang komune,në vitin 1954.

Nga viti 1954 e deri më sot,Komuna e Klinës dhe qytetarët e saj ka ndarë fatin me pjesën tjetër të Kosovës dhe të qytetarëve të saj duke qenë pjesë e të gjitha proceseve dhe e zhvillimeve politike,ekonomike dhe shoqërore në Republikën e Kosovës.Diagrami i këtyre zhvillimeve ka patur herë herë rënje dhe degradim e herë herë ngritje dhe përparim,por shpirti liridashës qytetarëve të saj nuk pushoj se gjakuari për liri deri në pavarësimin e plotë nga okupimi serb.

Në rrafshin ekonomik,në Komunën e Klinës si dhe në gjithë Kosovën, nga viti 1970 e deri në vitin 1980 vërehet një ndryshim pak më i theksuar sa i përket zhvillimit ekonomik dhe shoqëror,por nga viti 1980 e deri në fillimin e luftës së fundit prapë kemi një stagnim si pasojë e okupimit klasik nga pushteti okupues serb.Nga lufta pati pasoja shumë të rënda si : humbja e jetës së njerëzve,zhdukja e tyre dhe një numër i konsiderueshëm te pagjetur edhe sot .Nga lufta u shkaktërruan në tërësi dhe pësuan dëme shumë të mëdha të gjitha ndërmarrjet ekonomike ekzistuese dhe pothuajse të gjitha shtëpitë e banimit dhe ekonomitë e tyre familjare.Edhe infrastruktura fizike,edhe pse e pa zhvilluar pësoi dëme të konsiderueshme si pasojë e luftës.Me një fjalë duhej filluar një jetë e re dhe gjithçka duhej filluar nga zeroja.

Të gjitha këto ishin dhe do jen një barrë e madhe për pushtetin lokal të pasluftës, të cilat nuk ishte lehtë të tejkalohen për të arritur deri në një fazë të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe rritjes se mirëqenjes qytetare siq e aspirojmë duke marr për model komunat e vendeve të zhvilluara ekonomikisht.

## Pozita gjeografike e Klinës

Klina si komunë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike , shtrihet në perëndim të Kosovës, në veri-lindje të Rrafshit të Dukagjinit. Komuna e Klinës ka sipërfaqe prej 308.8 km $^{2}$ . Kufizohet me këto komuna: Pejën, Istogun, Skënderajn, Drenasin, Malishevën, Rahovecin dhe Gjakovën.




Pozita e Klinës në harten e Kosovës

Komuna e Klinës është themeluar në vitin 1954 dhe ka 14 bashkësi teritoriale (qendra të fshatrave) me gjithsej 54 vendbanime.

Pozita natyrore dhe konfiguracioni mundëson që Klina të ketë lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore. Nëpër Klinë kalon rruga magjistrale Prishtinë Klinë-Pejë, rruga Klinë-Skenderaj-Mitrovicë, Klinë-Istog-Pejë si dhe vijat hekurudhore Fushë Kosovë-Klinë-Pejë dhe Fushë Kosovë-Klinë-Prizren.

Territori i Klinës dhe i tërë Dukagjinit përbën një pjesë të mbyllur më vete dhe të rrethuar me male. Drini luan rol të madh në lidhjet në mes këtij territori e Republikës së Shqipërisë.Përmes Llapushës lidhet me Prishtinën e më larg. Rrugët që çojnë kah Gjakova, Peja, Gurrakoci, Prishtina dhe tani kah Skënderaj, të gjitha këto të asfaltuara, i mundësojnë këtij territori lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës. Vija hekurudhore që kalon nëpër territorin e Klinës, ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin e komunës së Klinës.

Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike veçanërisht në pjesën e Rrafshit të Dukagjinit janë të volitshme për zhvillimin e bujqësisë: kultivimit të kulturave bujqësore, perimeve, pemëve dhe kushteve të mira për zhvillimin e blegtorisë dhe bletarisë . Nëpër territorin e Klinës kalojnë gjashtë lumenj:
Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës, Klina, Mirusha , Lumi i Istogut dhe Lumbardhi i Deqanit. Prej tyre katër kanë rrjedhë fushore dhe me ndërtimin e ujë nxënieve (pendave) përgjatë rrjedhës së tyre do të mund të ujiteshin deri në 2.000 ha toka bujqësore.Me realizimin e projekteve për ndertimin e kanaleve të ujitjës dhe pendave gjer me tani ujiten rreth 1200 ha tokë bujqësore.

Klima e këtij territori ka karakteristikat e klimës së butë kontinentale, me ndikim të klimës mesdhetare Temperatura mesatare e ajrit është 11.3 gradë celsius.
Klina hyn në zonën intensive për nga mundësitë e zhvillimit të bujqësisë , pasi që 87.7 % e sipërfaqes është nën 600 metra të lartësisë mbidetare. Tokë bujqësore është 95%, vetëm 4.9% janë toka jopjellore. Në strukturën e tokave bujqësore dominojnë arat me 12.734 ha, pyjet me 12.735 ha, livadhet me 2.184 ha, kullosat me 2.043 ha etj.

Klina ka resurse natyrore minerale dhe jo minerale: rezerva të linjitit 2 miliardë tonë, të xehes se boksitit 2 milionë tonë, të argjilës 6.5 milionë tonë, të rërës dhe zhavorrit 3.5 milionë tonë.
Përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha në pjesën jugore dhe jug-perëndim te Klinës janë ujëvarat, një bukuri e rrallë natyrore me një botë bimore dhe shtazore të pasur. Ky kompleks me një sipërfaqe prej 200 ha është një zonë e mbrojtur-rezervat, me mundësi te mira për zhvillimin e turizmit.




**Shtrirja gjeografike e Komunës së Klinës dhe komunave që e rrethojnë**

Territori i komunës dhe emërtimet e fshatrave apo vendbanimeve janë të përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave. Komuna e Klinës është e përberë prej këtyre fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane:

**Tabela 3. Vendbanimet e Komunës së Klinës**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bokshiq | Dush | Kpuz | Rixhevë |
| Berkovë | Dush i vogël | Krushevë e Madhe | Rudicë |
| Binxhë | Gllarevë | Krushevë e vogël | Sferkë |
| Budisalc | Grabanicë | Leskoc | Siqevë |
| Caravik | Grabc | Nagllavë | Stupë |
| Çabiq | Gremnik | Përqevë | Shtupel |
| Deiq | Gjurgjevik i Madh | Poterq i Epërm | Ujmir |
| Doderdol | Gjurgjevik i Vogël | Poterq i Poshtem | Videjë |
| Dollc | Jagodë | Pograxhë | Volljakë |
| Dollovë | Jashanicë | Qeskovë | Zabergjë |
| Dranashiq | Jelloc | Qupevë | Zajm |
| Drenoc | Kërnicë | Radulloc | Zllakuqan |
| Dersnik | Klinavc | Ranoc | |
| Dugajevë | Klinë | Resnik | |




**Vendbanimet e Komunës së Klinës**

## Popullësia

Me regjistrimin e vitit 1981 Klina kishte 42.813 banorë me këte strukturë kombëtare: shqiptar 83.6 %, serb 12.5 % dhe të tjerë 3.9 %.Pas këtij regjistrimi deri në vitin 2011 nuk kemi regjistrim të besueshëm të popullësisë pasi që popullësia shqiptare nuk merrte pjesë në regjistrimet e popullësisë që bëheshin nga pushteti serb duke e ditur se të dhënat e regjistrimit,veqmas sa i përket strukturës nacionale te popullësisë mund te manipuloheshin për interesa të politikës ditore serbe dhe si te tilla nuk ishin te besueshme.

Ndërkaq me regjistrimin e vitit 2011,pas një periudhe tridhjetëvjeqare kemi një regjistrim kredibil dhe në pajtueshmëri me kritere dhe standarde ndërkombtarisht të pranuara dhe të krahasueshme.Në vijim do të japim pasqyrën e popullësisë se komunës se Klinës sipas vendbanimit,gjinisë dhe etnicitetit nga reazultatet e regjistrimit te popullësisë në vitin 2011 nga Enti statistikor i Kosovës.

Me regjistrimin e vitit 2011,Klina ka një popullësi prej 38.496 banorë resident,prej te cilëve 37.216 janë shqiptar,98 serb,3 turq,20 boshnjak,78 romë,85 ashkalinj,934 egjiptian dhe 23 te tjerë. Pasi që me regjistrimin e vitit 2011 nga aspekti metodologjik janë përfshirë vetëm banorët resident të komunës në ditën e regjistrimit,vlerësojmë se numri I banorëve jo resident në komunën e Klinës është rreth 11.000 banorë ,kështu që numri I përgjithshëm I banorëve resident dhe jo resident arrin në 50.000 banorë.

## Popullsia e Komunës së Klinës sipas vendbanimit,gjinisë dhe etnicitetit

| | Vendbanimi | gjithsejt | Mashkuj | Femra | Shqiptar | Serb | Turq | Boshnjak | Romë | Ashkalinj | Egjiptian | Goran | Te tjerë | Pa përgjigje | Pa të dhën |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsejt | 38,496 | 19,193 | 19,303 | 37,216 | 98 | 3 | 20 | 78 | 85 | 934 | | 23 | 7 | |
| | Urban | 5,542 | 2,713 | 2,829 | 5,339 | 3 | | 6 | | 13 | 167 | | 11 | 1 | |
| | Rural | 32,954 | 16,480 | 16,474 | 31,877 | 95 | 3 | 14 | 78 | 72 | 767 | | 12 | 6 | |
| 1 | Bërkovë | 246 | 124 | 122 | 202 | 28 | 1 | - | - | - | 15 | - | - | - | |
| 2 | Binxhë | 117 | 64 | 53 | 105 | | | | | | 12 | | | | |
| 3 | Bokshiq | 433 | 214 | 219 | 433 | | | | | | | | | | |
| 4 | Budisalc | 398 | 212 | 186 | 338 | | | 2 | 17 | 6 | 34 | - | 1 | | |
| 5 | Caravik | 1,241 | 596 | 645 | 1,241 | | | | | | | | | | |
| 6 | Çabiq | 862 | 414 | 448 | 861 | | | | | | | | | | |
| 7 | Deiq | 376 | 183 | 193 | 376 | | | | | | | | | | |
| 8 | Dobërdol | 339 | 180 | 159 | 339 | | | | | | | | | | |
| 9 | Dollc | 276 | 141 | 135 | 273 | 3 | | | | | | | | | |
| 10 | Dollovë | 444 | 213 | 231 | 439 | | | | 5 | | | | | | |
| 11 | Dranashiq | 21 | 12 | 9 | 9 | | | | | | 12 | | | | |
| 12 | Drenoc | 440 | 210 | 230 | 438 | | | | | | | | | | |
| 13 | Dresnik | 1,770 | 895 | 875 | 1,751 | 10 | | | | | 4 | | 1 | | |
| 14 | Dugajevë | 399 | 203 | 196 | 368 | | | | | | 28 | | | | |
| 15 | Dush | 241 | 119 | 122 | 241 | | | | | | | | | | |
| 16 | Dush I Vogël | 196 | 94 | 102 | 196 | | | | | | | | | | |
| 17 | Gllarevë | 1,784 | 876 | 908 | 1,782 | | | 1 | | | | | 1 | | |
| 18 | Grabanicë | 728 | 368 | 360 | 689 | | | | | | 39 | | | | |
| 19 | Grapc | 206 | 106 | 100 | 174 | | | | | | 32 | | | | |
| 20 | Gremnik | 1,131 | 574 | 557 | 1,129 | | | | | | | | | | |
| 21 | Gjyrgjevik I Madh | 449 | 235 | 214 | 447 | | | | | | | | | | |
| 22 | Gjyrgjevik I Vogël | 745 | 368 | 377 | 671 | | | | | 6 | 68 | | | | |
| 23 | Jagodë | 197 | 100 | 97 | 197 | | | | | | | | | | |
| 24 | Jashanicë | 1,784 | 933 | 851 | 1,765 | | 1 | 5 | | 13 | | | | | |
| 25 | Jelloc | 27 | 14 | 13 | 27 | | | | | | | | | | |
| 26 | Kërnicë | 794 | 383 | 411 | 791 | | | | | | 3 | | | | |
| 27 | Klinafc | 480 | 237 | 243 | 372 | | | 1 | | 6 | 95 | | 1 | 2 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 28 | Klinë | 5,542 | 2,713 | 2,829 | 5,339 | 3 | | 6 | | 13 | 167 | | 11 | 1 | |
| 29 | Këpuz | 622 | 325 | 297 | 620 | | | | | | | | | 2 | |
| 30 | Kryshevë e Madhe | 585 | 299 | 286 | 504 | 25 | | | 33 | 1 | 21 | | 1 | | |
| 31 | Kryshevë e Vogël | 323 | 162 | 161 | 323 | | | | | | | | | | |
| 32 | Leskoc | 239 | 122 | 117 | 239 | | | | | | | | | | |
| 33 | Nagllavë | 67 | 33 | 34 | 46 | | | | | 9 | 12 | | | | |
| 34 | Përqevë | 1,005 | 488 | 517 | 1,004 | | | | | | | | 1 | | |
| 35 | Pjetërq I Epërm | 563 | 274 | 289 | 522 | | | | 14 | | 26 | | | | |
| 36 | Pjetërq I Poshtëm | 160 | 82 | 78 | 160 | | | | | | | | | | |
| 37 | Pograxhë | 366 | 179 | 187 | 366 | | | | | | | | | | |
| 38 | Qeskovë | 373 | 182 | 191 | 373 | | | | | | | | | | |
| 39 | Qupevë | 579 | 316 | 263 | 579 | | | | | | | | | | |
| 40 | Radulloc | 353 | 171 | 182 | 344 | | | | 4 | | | | 5 | | |
| 41 | Ranoc | 353 | 181 | 172 | 353 | | | | | | | | | | |
| 42 | Resnik | 399 | 207 | 192 | 380 | | | | | 16 | | | | | |
| 43 | Rixhevë | 870 | 413 | 457 | 870 | | | | | | | | | | |
| 44 | Rudicë | 446 | 229 | 217 | 311 | 21 | | | | | 114 | | | | |
| 45 | Sferkë | 2,448 | 1,245 | 1,203 | 2,441 | | | | | | | | 1 | | |
| 46 | Siqevë | 1,338 | 664 | 674 | 1,337 | | | | | | | | | | |
| 47 | Stupë | 179 | 91 | 88 | 174 | | | | 5 | | | | | | |
| 48 | Shtupel | 771 | 384 | 387 | 619 | | 1 | 1 | | | 147 | | 3 | | |
| 49 | Ujmirë | 544 | 269 | 275 | 541 | 1 | | | | | | | 1 | | |
| 50 | Videjë | 663 | 349 | 314 | 547 | 4 | | | | 15 | 97 | | | | |
| 51 | Volljak | 929 | 444 | 485 | 929 | | | | | | | | | | |
| 52 | Zabërgjë | 728 | 364 | 364 | 724 | | | 4 | | | | | | | |
| 53 | Zajm | 1,267 | 617 | 650 | 1,259 | | | | | | 8 | | | | |
| 54 | Zllakuqan | 660 | 322 | 338 | 658 | | | | | | | | | | |

## Vlerësimet e numrit të popullësisë në vitin 2014

Sipas vlerësimit të Agjencionit të statistikave të Kosovës,numri i popullësisë me 2013 (31.12.2013) sipas vlerësimeve ka qenë 39.555 banorë, nataliteti apo shtimi natyror gjatë vitit 2014 ka qenë 930 banorë, mortaliteti(vdekjet) 178 banorë dhe shtimi natyror neto (nataliteti minus

mortaliteti) 752 banorë, prandaj vlerësimi i numrit të banorëve me 31.12.2014 është 40307 banorë.Gjatë vitit 2014 imigrimet ndërkombtare janë për 125 banorë, emigrimet 872 banorë dhe bilanci negative -747 banorë.Imigrimet kombëtare janë për 228 banorë,emigrimet për 261 banorë dhe bilanci negativ për -33 banorë. Tani nëse marrim parasysh rezultatet e vlerësimit të popullësisë me 31.12.2013 (39.555 banorë) shtimit natyror neto (752 banorë), imigrimet neto dhe emigrimet neto (-780 banorë) atëherë na del rritja e popullësisë për vitin 2014 negative për -28 banorë. Këto vlerësime dhe këto trende e kanë rëndësinë e vet se na japin një pasqyrë të zhvillimeve demografike dhe tranzicionit demografik që është duke ndodhur edhe tek ne , e që tregon thënë se numri i popullësisë do të jetë pak a shumë në nivel të njëjtë dhe nuk pritet ndonjë rritje e theksuar e numrit të popullësisë në vitet vijuese,bile pas një periudhe pesëvjeçare mund te pritet fillimi I një rënje të vogël bazuar në trendet e tranzicionit demografik që nënkupton se zhvillimi ekonomik dhe dhe zhvillimi demografik kane ecuri në kahe të kundërta

## Të dhëna demografike dhe pronësore të ekonomive familjare në Komunën e Klinës

- Nga numri i përgjithshëm i popullësisë prej 38496 banorë sipas regjistrimit të popullësisë te vitit 2011,21387 banorë janë 0-27 vjeq ose mbi 55% te popullësisë,
- Kontigjenti i aftë për punë përkatësisht popullësia e grupmoshës prej 15-64 vjet përbëhet prej 24491 banorësh,përkatësisht 63.62 % e popullësisë se Komunës se Klinës prej tyre 12135 janë mashkuj dhe 12356 femra.
- Popullësia mbi moshën prej 65 vjet është 2607 banorë apo 6.77%.
- Nga pikëpamja fetare, popullësia e komunës se Klinës ka këtë strukturë:31185 ose 81% i përkasin besimit islam (15507 mashkuj dhe 15678 femra),7124 ose 18.50% besimit katolik (3588 mashkuj dhe 3536 femra) dhe 100 ose 0.30% (50 mashkuj dhe 50 femra) te tjerë.
- Sa i përket nivelit të arsimit kemi këte strukturë:Pa shkollë fillore janë 3289 veta, prej tyre 1218 mashkuj dhe 2071 femra.Nga këta 3289 banorë,2102 banorë (944 mashkuj dhe 1158 femra) dinë shkrim dhe lexim,ndërsa 1187 (274 mashkuj dhe 913 femra) nuk dinë shkrim-lexim pra janë analfabet.Sa i përket niveleve tjera te arsimit:2664 janë me katër klasë arsim,3666 me pesë klasë,8384me tetë klasë,4320 me nëntë klasë,4735 me dymbëdhjetë klasë,2382 me 13 klasë,646 me shkollë të lartë,1040 me fakultet-baçelor,127 master dhe pasuniversitar,18 doktor dhe PHD.
- Klina ka 8637 familje,prej tyre 1401 në pjesën urbane dhe 7236 familje në pjesët rurale të komunës.Pasi që një pjesë e familjeve jetojnë në bashkësi familjare,në komunën e Klinës ka gjithsej 5843 ekonomi familjare (1062 në pjesën urbane dhe 4781 në pjesën rurale),me një mesatare prej 6.6 banorë për një ekonomi familjare.Prej 8637 familjeve 1696 familje (299 në zonën urbane dhe 1397 në zonën rurale) kanë nga 2 anëtarë,1421 familje (262 në zonën urbane dhe 1159 në zonën rurale)kanë nga tre anëtarë të familjes,1772 (308 në zonën urbane dhe 1464 në zonën rurale) kanë nga katër anëtarë të familjes,1777 familje (286 në zonën urbane dhe 1491 në zonën rurale )kanë nga pesë anëtarë të familjes dhe 1971 familje (246 në zonën urbane dhe 1725 në zonën rurale) kanë nga gjashtë e më shumë anëtarë të familjes.
- Prej 5843 ekonomive familjare,4766 ekonomi familjare kanë tokë në shfrytëzim.Pjesa ma e madhe e tyre ,përkatësisht 4001 familje kanë tokë bujqësore në posedim nga 0-3 hektarë

dhe vetëm 765 familje kanë tre e më shumë hektarë. Sipërfaqja që posedojnë në shfrytëzim këto ekonomi familjare është rreth 9600 hektarë,prej tyre me grurë 4650 hektarë, misër 2950 hektarë,tërshërë 385 hektarë ,thekër 150 kektarë, elb 45 hektarë, bimë foragjere 1100 hektarë, patate 125 hektarë dhe perime e te tjera 205 hektarë(shënim:nga te dhënat e Drejtorisë se bujqësisë).

- Nga 5843 ekonomi familjare,3339 prej tyre kanë ekonomi bujqësore dhe 2504 nuk kanë ekonomi bujqësore.
- Nga 5843 ekonomi familjare,2479 ekonomi familjare kanë të punësuar.Prej 2479 ekonomive familjare me te punësuar,1365 prej tyre kanë edhe ekonomi bujqësore në posedim ,ndërsa 1154 prej tyre nuk kanë ekonomi bujqësore.1567 ekonomi familjare kanë nga një të punësuar,603 ekonomi familjare nga dy të punësur dhe 309 ekonomi familjare nga tre të punësuar.3364 ekonomi familjare nuk kanë të punësuar.
- 3339 ekonomitë familjare që kanë ekonomi bujqësore kanë në posedim:4736 lopë,956 dele,217 dhi,2067 derra dhe 3800 koshere bletësh.Këto ekonomi bujqësore posedojnë mekanizëm bujqësor si në vijim:1620 traktor njëboshtor,233 traktorë dyboshtor,102 autokombajna dhe 78 kamion.

## Numri i nxënësve , shkollave dhe personelit arsimor në shkollat e Komunës së Klinës në vitin shkollor 2015-2016

### Arsimi parashkollor dhe parafillor ( mosha 0-6 vjeçar)

Në arsimin parashkollor gjatë vitit shkollor 2015 – 2016, kemi pasur 42 fëmijë të moshës 0-5 vjeç në çerdhen publike të fëmijëve . Në 15 klasa parafillore të shkollave fillore kanë vijuar mësimin 412 fëmijë. Nga projekti i financuar nga Save the Children në këtë vit është hapur klasa parafillore në Zajm paralele e shkollës fillore " MotratQiriazi " me 17 fëmijë të moshes 5-6 vjeçarë dhe një grup të moshës 3-5 vjeçarë me 21 fëmijë. Gjithësej fëmijë të moshës 0- 6 vjeçarë në institucionet parashkollore publike në vitin shkollor 2015/ 2016 janë 450 nxënës, prej tyre 219 meshkuj dhe 231 femra.Edukatorë/e në klasat parafillore janë 16 prej tyre 3 meshkuj 13 femra, në çerdhen publike 2 motra edukatore dhe 2 edukatore.

### Arsimi fillor dhe i mesëm i ultë publik ( klasa 1-9 )

Në këtë nivel të shkollimit në vitin shkollor 2015-2016 kemi pasur 6503 nxënës, prej tyre 3263 në nivelin fillor ( klasa 1-5) dhe 3240 në atë të mesem të ulët (klasa 6-9 ).Sa i përket përkatësisë etnike nga 6503 nxënës prej tyre 6272 nxënës janë shqiptarë, 148 ashkalinjë, 74 romë, 9 egjiptian, kurse sipas bazës gjinore 3297 meshkuj dhe 3206 femra. Kjo përfshirje ka qenë në 17 shkolla amë dhe 9 paralele të ndara . Në klasen e parë 621 nxënës, në klasën e dytë 669, në klasën e tretë 666, në klasën e katërt 648 nxënës, në klasën e pestë 659 nxënës,në klasën e gjashtë 741 nxënës, në klasën e shtatë 759 nxënës, në klasën e tetë 848 nxënës, në klasën e nënt 892 nxënës. Në këtë nivel të shkollimit punojnë 435 mësimdhënës , prej tyre 191 femra dhe 244 meshkuj, personel

administrativ 26 , prej tyre 22 meshkuj dhe 4 femra, kurse personel ndihmës 60 punëtor ,prej tyre 59 meshkuj dhe 1 femer.

## Arsimi i mesëm i lartë publik dhe privat ( klasa 10-12 )

Në komunën e Klinës funksionojnë tri shkolla të mësme të larta , dy publike ( gjimnazi dhe shkolla profesionale ) dhe një private ( shkolla e mesme e mjekësisë ) . Numëri i nxënësve në nivel komune për vitin shkollor 2015-2016 ishte 1753 në shkollat publike dhe 24 në shkollën private, gjithësej 1777 nxënës . Në gjimnaz në këtë vit shkollor ishin 860 nxënës prej tyre 545 femra dhe 315 meshkuj.Në shkollën e mesme profesionale 893 nxënës , prej tyre 582 meshkuj dhe 311 femra. Kurse në shkollën e mjekësisë 24 nxënë sprej tyre 15 meshkuj dhe 9 femra.Në bazë të klasave në nivel komune në klasën e dhjetë ishin 733 nxënës, në klasën e njembëdhjet 487 nxënës dhe në klasën e dymbëdhjet 557. Në bazë të gjinisë kemi këtë përfshirje : 912 meshkuj dhe 865 femra.Kurse në bazë të përkatësisë etnike 1769 janë shqiptarë, 5 ashkalinj,1 romë, 2 egjitian.Në këtë nivel punojnë 110 mësimdhënës, prej tyre 90 meshkuj dhe 20 femra , personel administrativ 4 meshkuj dhe 1 femer, kurse personel ndihmes 15 meshkuj.

## Gjendja ekzistuese në shëndetësi-Infrastruktura ekzistuese shëndetësore (njerëzore dhe fizike)

Në komunën e Klinës funksionon një QKMF (Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare), tri QMF (Qendra e Mjekësisë Familjare), si dhe njëmbëdhjetë AMF (Ambulanca të Mjekësisë Familjare). Numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin shëndetësor është 138. Sipas strukturës gjinore meshkuj janë 66 të punësuar ndërkaq femra 72. Sipas strukturës nacionale 136 janë shqiptarë ndërsa 2 të punësuar janë të tjerë (të komuniteteve pakicë). Nga ky numër i përgjithshëm 15 janë specialistë, 14 mjek të përgjithshëm, 1 stomatolog, 79 motra medicinale, 10 punëtor administrativ, 11 punëtor ndihmës dhe 8 shoferë. Në Komunën e Klinës funksionon edhe seksioni i gjinekologjisë në kuadër të QKMF . Në këtë komunë janë në dispozicion 2.5 mjek për 1,000 banorë.
Institucionet shendetësore që funksionojnë në Komunën e Klinës janë :

1. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "NënëTereza" në Klinë
2. Qendra e Mjekësisë Familjare në Zllakuqan
3. Qendra e Mjekësisë Familjare në Ujmirë
4. Qendra e Mjekësisë Familjare në Sverkë
5. Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Jashanicë
6. Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Jashanicë e Epërme
7. Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Drenoc
8. Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Caravik
9. Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Budisalc
10. Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Jagodë
11. Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Shtupel
12. Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Grabanicë
13. Ambulanta e Mjekësisë Familjare në Leskoc

Në Komunën e Klinës funksionon edhe sektori privat shendetësor që ofron shërbime të ndryshme shëndetësore për qytetarët .

## Gjendja ekzistuese në lëminë kulturës,rinisë dhe sportit

Infrastruktura fizike për zhvillimin e jetës kulturore është e kënaqshme. Komuna e Klinës ka kapacitete te mjaftueshme si njerëzore dhe infrastrukturore për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.Në komunen tonë ekziston një Qendër e Kulturës, Teatri amatorë „Osman R. Gashi'' si dhe SHKA „Mujë Krasniqi''.

Gjatë vitit mbahen katër manifestime tradicionale kulturo-artistike:

1.Festivali folklorik „I Këndojmë Lirisë''
2.Manifestimi letrar „Ora e Tahir Deskut''
3.Festivali i teatrit amator për fëmijë
4.Manifestimi „Art Klina''

Biblioteka Publike është e organizuar në kuadër të Drejtorisë për Kulture Rini dhe Sport, me sallën e librit në qytet dhe aneksin për lexues me një kapacitet prej 18 lexuesish dhe një degë në fshatin Drenoc, me një fond librar të pasur .

Infrastruktura për zhvillimin e aktiviteteve sportive është e mirë, duke iu falënderuar investimeve publike dhe atyre private. Jeta sportive është e organizuar dhe zhvillohet në kuadër të katër klubeve dhe katër shkollave.

1. Klubet e Futbollit – dy
2. Klubi i Volejbollit – një
3. Klubi i Shahit - një
4. Shkolla të Futbollit – katër

Në territorin e Komunës funksionojnë këto objekte, terrene sportive:

- Terrene Sportive te Futbollit të madh – dy
- Palestra Sportive Publike – një
- Terrene Sportive me bari sintetik për futboll të vogël (private) – katër .

Sektori i rinisë aktivitetet e veta i zhvillon ne bashkëpunim me sektorin e sportit dhe te kulturës, duke u bazuar në Planin e Veprimit Rinor Lokal. Në komunën e Klinës ekziston qendra Rinore "ARDHMERIA" ,Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL), Kuvendi i të Rinjve të Klinës (KRK), dy qendra tjera private.

## Gjendja ekzistuese në lëminë e trashëgimisë kulturore

Klina me rrethin është e pasur me lokalitete arkeologjike dhe me objekte të trashëgimisë kulturore.Fillet e jetës në trevat e Klinës datojnë që nga neoliti dhe para historia . Këto gjurmë jete i gjejmë në këto fshatra : Dollc,Pogragj, Jashanicë e Epërm, Qupevë e poshtme.
Gjurmët e kësaj periudhe janë gjetur në enët e qeramikës muret e kështjellave si është ajo e Dollcit, varreza të vjetra etj..
Lokalitetet arkeologjike janë të shumta , më të theksuar janë Dresniku, Dollci, Pogragja, Rixheva , Çabiqi, Siqeva, Jashanica, Zabergja, Gjurgjeviku.
Si objekte të trashëgimisë janë evidentuar : Kulla dhe ura janë (52), mullinjë (2) lokalitete arkeologjike (10), objekte te kultit gjamia (5), kisha mesjetare (11), kisha katolike (3), tyrbe (2), mejtepe (1), hambarë (6), muze privat (1). Komuna ka nevojë te investoj në ruajtjen, konservimin dhe hulumtimin e mëtutjeshëm .

## Gjendja sa i përket punësimit dhe papunësia

Kontigjenti i popullësisë së aftë për punë në komunën e Klinës,përkatësisht banorët e moshës 15-64 vjet arrin 24491 banorë (12135 mashkuj dhe 12356 femra),prej të cilëve ekonomikisht aktiv janë 8974banorë (6715 mashkuj dhe 2259 femra),ndërkaqqë numri i të punësuarve në Komunën e Klinës sipas regjistrimit te vitit 2011 ka qenë 3790 (3026 mashkuj dhe 764 femra).Popullësia ekonomikisht joaktive përbëhet nga 15517 banorë (5420 mashkuj dhe 10097 femra). Sipas veprimtarive ekonomike numri i të punësuarve ka këtë strukturë:

| | |
|---|---|
| 140 | Bujqësi,gjueti dhe pylltari |
| 49 | Industri nxjerrëse, |
| 307 | Industria përpunuese |
| 50 | Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike,e gazit dhe ujit |
| 274 | Ndërtimi |
| 659 | Tregtia me shumicë dhe pakicë,riparimi i automobilave dhe artikujve etj |
| 247 | Hotelet dhe Restorantet |
| 201 | Transportet,magazinimi dhe komunikacioni |
| 99 | Ndërmjetësimi financiar |
| 110 | Pasuritë e patundshme,dhënja me qira dhe shërbimet për ndërmarrjet |
| 599 | Administrimi publik dhe mbrojtjes se sigurimit social të detyruar |
| 670 | Arsimi |
| 193 | Shëndeti dhe veprimtaritë sociale |
| 153 | Aktivitete te tjera të shërbimeve kolektive,sociale dhe personale |
| 6 | Aktivitete te ekonomive familjare dhe shërbime shtëpiake |
| 33 | Aktivitetet e organizatave dhe organeve eksteritoriale |

Prej 3790 te punësuarëve (3026 mashkuj 764 femra),të punësuar në sektorin public dhe privat janë 3184 (2479 mashkuj dhe 705 femra),të punësuar në bujqësi 135(125mashkuj dhe 10 femra),të vetëpunësuar dhe punëtorë në tokën e vet pa punëtor me pagesë 413(381 mashkuj dhe 31 femra),persona që asistojnë të afërmit në biznes familjar pa pagesë fikse përfshirë edhe tokën 57(39 mashkuj dhe 18 femra).

Numri ma i madh I të punësuarve në të gjitha kategoritë e mësipërme i përket grupmoshës 25-54 ( mbi 77 %),ndërsa shumë më pak grupmoshave 15-24 (12.88%) dhe 55-64(9.87%).që do me thënë se kemi nivel shumë të lartë të papunësisë se të rinjve që për herë të parë hyjnë në tregun e punës.Sa i përket strukturës kualifikuese të të punësuarëve prej 3790 te punësuarve,numri më i madhë i të punësuarve është me arsim te mesem 1896 ose 50%,pastaj me fakultet niveli bachelor 667 ose 17.60%,me shkollë fillore 667 ose 17.60%,me shkollë të lartë 421 ose 11.11%,me arsim pasuniversitar 107 ose 2.82% dhe pa arsim 15 ose 0.40%.
Sa I përket kategorive tjera që kanë të hyra nga burime tjera: 2623 kanë të hyra nga pensioni (506 në zonën urbane dhe 2117 në zonën rurale), 2972 kanë të hyra nga ndihmat dhe 2772 kanë te hyra nga remitencat (483 urbane dhe 2489 rurale),ndërsa mbështetje nga personat tjerë,përkatësisht të varur nga te hyrat e të tjerëve janë 17153 veta (2226 urbane dhe 14927 rurale).

Të dhënat e prezentuara më sipër tregojnë se sikurse në nivel të vendit, edhe në Komunën e Klinës, papunësia paraqet një problem tejet brengosës. Në Komunë janë të evidentuar 5929 vetë të papunë,por numri i të papunëve është dukshëm më i madhë duke marrë parasysh faktin se një numër i të paunëve nuk paraqitet fare dhe nuk përfshihet në evidencën e të papunësuarve në Qendrën komunale të punësimit për arësye të mundësive të kufizuara që ka kjo Qendër për t'u siguruar një vend pune. Meshkujt marrin pjesë me numër më të madh në strukturën e të papunëve, në krahasim me femrat : 3506 janë meshkuj, ndërsa 2423 janë femra. Edhe për sa i përket strukturës gjinore të të papunëve sipas shkallës së arsimimit , numri i femrave të papunësuara është dukshëm më i vogël, në krahasim me meshkujt.
Në strukturën kualifikuese të të papunëve dominojnë të pa kualifikuarit (3146 ) , gjysme të kualifikuarit (407 ) ,të kualifikuarit (149 ) , me shkollë të mesme ( 2037 ) , me shkollë të lartë ( 32 ) dhe ata me fakultet ( 158 ). Numri i të papunëve me shkollë të lartë (32) dhe me fakultet (158 ) është dukshëm më i vogël në krahasim me nivelet më të ulëta të kualifikimeve.
Pra papunësia paraqet problem të hidhur, me të cilin ballafaqohet Komuna e Klinës, por me përmirësimin e klimës së biznesit, nxitjen e aktiviteteve investuese, ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, do të krijohen mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës dhe në këtë mënyrë, në rritjen e numrit të të punësuarve.
Të dhënat për numrin e personave të papunësuar në komunën e Klinës, mund të shihen nga tabelat e paraqitura në vijim :

**Pasqyrë e personave të papunësuar sipas shkallës së arsimimit**

| Qendra për Punësim - Klinë | Gjithsej | Gjithsej | | Të pakualif. | | GJKV | | Të kualif. | | Me shkollë të mesme | | Me shkollë të lartë | | Me fakultet | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. |
| | 1=2+3 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| | 5929 | 3506 | 2423 | 1579 | 1567 | 174 | 233 | 133 | 16 | 1518 | 519 | 21 | 11 | **81** | 77 |

**Pasqyrë e personave të papunësuar sipas përkatësisë kombëtare**

| Qendra për Punësim - Klinë | Gjithsej | Gjithsej | | Shqiptarë | | Serb | | Boshnjak | | Ashkali | | Rom | | Tjerë | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. | Mesh. | Fem. |
| | 1=2+3 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
| | 5929 | 3506 | 2423 | 3364 | 2356 | 32 | 10 | - | 4 | **19** | 14 | **8** | 5 | 83 | 34 |

**Numri real i të papunëve është shumë më i lartë, pasi një pjesë e madhe e të papunëve nuk lajmërohen në zyrat e punësimit.**

## Pasuritë (resurset) natyrore

Komuna e Klinës është mjaft e pasur me pasuri natyrore minerale dhe jo minerale , të cilat janë bazë për tërheqjen e investimeve të huaja dhe zhvillimit ekonomik në përgjithësi , siq janë :
- Rezervat e thengjillit
- Minerale të boksitit
- Argjilë
- Rërë e zhavor dhe
-Guri për ndërtim dhe dekorim

## Pasuritë (resurset) turstike

Klina me bukuritë e saj natyrore ka potencial për zhvillimin e turizmit rekreativo-turistik . Parku "Ujëvarat e Mirushës", është një ndër zonat më të bukura dhe më interesante të natyrës së Kosovës, i cili shtrihet në territorin e komunave Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Sipërfaqja e territorit të parkut është 598.4 ha. Lartësia mbidetare e parkut është 340 – 600 m. Parku gjendet në jug të maleve Gremnik, në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha.
Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Ujëvarat e Mirushës" është park që paraqet një fenomen të rrallë natyror me rëndësi të veçanet natyrore, shkencore, kulturore dhe turistike. Në këtë park, lumi Mirusha në pjesën e fundit të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanjoni i lumit Mirusha dhe këtu ai krijon 12 ujëvara dhe 16 liqene që paraqesin një fenomen të rrallë morfo-hidrologjik dhe peizazh shumë të bukur e atraktiv për vizitorë.
Përveç ujëvarave e liqeneve, bukuri të rrallë parkut të Mirushës i jep edhe flora dhe fauna e pasur me shumë lloje të shatzëve dhe të bimëve.
Pika të tjera atraktive për vizitorët paraqesin edhe disa shpella që ndodhen në shkëmbinjtë e kanjonit të lumit. Pasuritë e natyrës që krijojnë një peizazh të bukur dhe tërheqës për vizitorë, paraqesin një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit. Momentalisht parakushtet e nevojshme për zhvillimin e turizmit e në radhë të parë infrastruktura fizike, nuk janë të plotësuara.







**Pamje nga Parku "Ujëvarat e Mirushës"**

# Gjendja ekzistuese ekonomike,numri dhe sruktura e Ndërmarrjeve të vogëla dhe të mesme

Ekonomia në territorin e komunës së Klinës viteve të fundit ka shënuar rritje të vazhdueshme. Si veprimtari më të zhvilluara janë : tregtia , bujqësia, ndërtimtaria , industria e përpunimit të drurit dhe plastikës etj. Gjithashtu, rritja e vazhdueshme e ekonomisë mund të vërehet edhe nga rritja permanente e numrit të subjekteve ekonomike që veprojnë në rajonin e Klinës. Prej tyre 98% u takojnë ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Sipas të dhënave të Zyrës për regjistrimin e bizneseve , numri i përgjithshëm i subjekteve afariste të regjistruara në komunën e Klinës deri në shtator 2016 është **2460.** Nga të dhënat e regjistrimit të bizneseve (shtator 2016) vërehet qartë dominimi i ndërmarrjeve tregtare dhe shërbyese. Numri i bizneseve prodhuese mbetet shumë i ulët së bashku me ndërtimtarinë dhe sektorin e bujqësisë. Tregtia me pakicë dhe shumicë veprimtarinë kryesore në strukturën e veprimtarive ekonomike të Ndërmarrjeve të vogëla dhe te mesme në Klinë ekonomisë së Komunës së Klinës.
Sipas shënimeve me të cilat dipsonon Komuna, dominojnë ndërmarrjet e vogla që kanë më pak se 10 punëtorë dhe numri më i madhë i NVM-ve janë familjare.

Numri i subjekteve afariste sipas llojit dhe veprimtarisë është sipas tabelave në vijim :

**Tabela 7: Klasifikimi i subjekteve afariste sipas veprimtarive**

| NR. | LLOJI I VEPRIMTARISË | NUMRI I NDËRMARRJVE | % |
|---|---|---|---|
| 1 | Tregtare | 930 | 37.80 |
| 2 | Shërbyese | 570 | 23.17 |
| 3 | Prodhuese | 412 | 16.75 |
| 4 | Ndërtimore | 308 | 12.52 |
| 5 | Bujqësore | 138 | 5.61 |
| 6 | Të tjera | 102 | 4.15 |
| | **Gjithsej :** | 2460 | 100 |

**Burimi: Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim**

**Tabela 8:Klasifikimi i subjekteve afariste sipas llojit**

| | Biznes individual | Shoqeri me përgjegjësi të kufizuar | Ortakëri e Përgjith. | Ortakëri e kufizuar | Shoqeri aksionare | Kompani e huaj | Ndermarrje shoqerore | Koperativë bujqesore | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri | 2272 | 129 | 41 | 2 | 9 | 2 | 1 | 4 | 2460 |
| % | 92.36 | 5.24 | 1.67 | 0.08 | 0.37 | 0.08 | 0.04 | 0.16 | 100 |

Nga të dhënat e tabelës (tabela nr. 7) vërehet qartë dominimi i ndërmarrjeve tregtare dhe shërbyese pastaj ndërmarrjet prodhuese dhe ndërtimore ndërsa në anën tjetër pjesëmarrja e bizneseve me veprimtari bujqësore është e ultë .
NVM klinase luajn rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Klinës. Ato janë burimi kryesor i krijimit të vendeve të reja të punës dhe të gjenerimit të të ardhurave. Punësimi në ndërmarrjet private është duke shënuar rritje dhe gjithashtu mund të vërehen ndryshime strukturore në kuadër të ndërmarrjeve, të cilat shprehen permës rritjes së pjesëmarrjes së ndërmarrjeve prodhuese.

**Shënim:**Në sektorin e bujqësisë shumë ekonomi familjare nuk janë të regjistruara, duke përfshirë plantazhet e mbjella me grurë, misër, kopshte, pemë dhe perime si dhe shumë fermerë të cilët mbajnë bagëti, të cilat veprimtari nuk janë të regjistruara askund.

## Gjendja ekzistuese e zhvillimit të bujqësisë

Kushtet e volitshme klimatike, si dhe relievi në rajonin e Komunës së Klinës , bëjnë të mundur krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e bujqësisë në komunën tonë . Si rezultat i kushteve të mira klimatike dhe cilësisë së tokës,viteve te fundit janë shtuar sipërfaqet e mbjella me drithëra të bardhë,

me pemë e perime, është rritur numri i fermave të lopëve qumështore të madhësive të ndryshme, ferma për kultivimin e gjedheve për majmeri.Në Komunën e Klinës është e zhvilluar mjaft edhe bletaria.
Në komunën tonë nga sipërfaqja e përgjithshme e punueshme bujqësore 85% është tokë e klasit të dytë deri në të katërtin ndërsa pjesa tjetër është nga klasa pesë deri në klasen tetë .Duke marrë parasysh këtë potencial të tokës bujqësore në komunën tonë ekzistojnë kushtet e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë e cila mund të jetë në funksion të rritjes së punësimit dhe burimit të jetesës për popullatën që jeton në ambientet rurale.
Shitja e prodhimeve bujqësore e blegtorale bëhët kryesisht në tregun kosovar dhe një pjesë e vogël e prodhimeve bujqësore shitet në tregjët e vendeve për rreth Kosovës.

**Të dhëna për tokën e punueshme**

| | Sipërfaqja në $km^2$ | Sipërf. Agrare kl (në hektar) | Tokë e punueshme (në hektar) | pyje (në hekt.) | Livadhe ( në hekt.) | kullota (në hekt.) | Tjera (në hekt ) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Komuna e Klinës** | 308.8 $km^2$ | | 12734 | 12735 | 2184 | 2034 | 1193 |

## Gjendja ekzistuese e infrastrukturës fizike

Gjatë periudhës 2010-2016 , Komuna ka investuar në realizimin e shumë projekteve kapitale të cilat kan ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës fizike për qytetarët e saj dhe bizneset. Vlera e investimeve në periudhen 2010-2016 është **18,501,560.77 €.** Nga totali i investimeve rreth **75%** apo në vlerë **13,906,390.89 €** janë investime nga Komuna , **13%** apo në vlerë **2,445,038.85 €** janë investime nga Ministritë ( MASHT,MMPH, MI etj . ) dhe **12%** apo në vlerë **2,150,131.03 €** janë investime nga Donatorët.

Në vitin 2010 vlera e investimeve ishte **2,467,226.72 €**
Në vitin 2011 vlera e investimeve ishte **4,297,261.68 €**
Në vitin 2012 vlera e investimeve ishte **1,640,950.92 €**
Në vitin 2013 vlera e investimeve ishte **3,063,354.00 €**
Në vitin 2014 vlera e investimeve ishte **2,748,621.00 €**
Në vitin 2015 vlera e investimeve ishte **1,276,783.00 €**
Në vitin 2016 vlera e investimeve ishte **3,007,363.45 €**

Investimet(projektet) e realizuara gjatë kësaj periudhe kategorizohen si më poshtë:

.

| Përshkrimi | Investimet | | | | | | | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | |
| Asfaltimi i rrug. lokale dhe trotuareve | 240,808.84 | 520,051.44 | 388,959.00 | 2,414,858.61 | 683,066.52 | 570,330.69 | 2,106,180.96 | 6,924,256.06 |
| Ujësjellës dhe kanalizim | 315,753.53 | 2,174,136.02 | 422,973.05 | 340,507.20 | 384,967.82 | 156,782.00 | 83,286.24 | 3,878,405.86 |
| Infrastrukturë shkollore | 194,219.82 | 365,987.77 | 421,803.57 | 64,905.97 | 1,099,460.34 | 309,987.93 | 442,794.30 | 2,899,159.70 |
| Investime në shendetësi | 73,362.56 | 3,411.50 | - | 5,500.00 | 5,921.50 | - | - | 88,195.56 |
| Investime në bujqësi | 159,531.67 | 657,172.00 | 36,905.50 | 4,400.00 | 224,735.22 | 56,930.00 | 83,935.86 | 1,223,610.25 |
| Investime tjera | 1,483,550.3 | 576,502.95 | 370,309.80 | 233,182.22 | 350,469.60 | 182,752.38 | 291,166.09 | 3,487,933.34 |
| **Gjithsej :** | **2,467,226.72** | **4,297,261.68** | **1,640,950.92** | **3,063,354.00** | **2,748,621.00** | **1,276,783.00** | **3,007,363.45** | **18,501,560.77** |
| **Komuna** | **1,557,448.00** | **3,236,391.68** | **967,632.56** | **2427558.00** | **2,407,621.00** | **987,793.20** | **2,321,946.45** | **13,906,390.89** |
| **Ministritë** | **656,024.00** | **180,000.00** | **270,000.00** | **472,504.85** | **300,000.00** | **-** | **566,510.00** | **2,445,038.85** |
| **Donatorët** | **253,754.72** | **880,870.00** | **403,318.36** | **163,291.15** | **41,000.00** | **288,989.80** | **118,907.00** | **2,150,131.03** |

# III. SWOT ANALIZA

Klina, si shumica e komunave në Kosovë, ballafaqohet me sfida të ndryshme zhvillimore, por njëkohësisht, për shkak të pozicionit gjeografik dhe potencialeve që ka, është edhe rast i mundësive për zhvillim të qëndrueshëm në sferën ekonomike, administrative dhe sociale. Në këtë drejtim analiza e përparësive, mundësive, dobësive dhe rreziqeve paraqet një faktor të rëndësishëm për të determinuar objektivat strategjike të komunës në pesë vitet e ardhshme.

| Përparësitë | Dobësitë |
|---|---|
| • **Pozitë e mirë gjeografike:lidhje te mira rrugore me shumicën e qyteteve te Kosovës,lidhje funksionale me hekurudhën për transport të udhëtarëve dhe mallrave,sipërfaqe te konsiderueshme te tokës bujqësore dhe mundësi të mira për ujitje të tokës bujqësore**<br>• **Burime (resurse) të pasura natyrore:tokë bujqësore,pyjore dhe kullota;resurse turistike:Ujëvarat e Mirushës,gryka e lumit Klina,lokaliteti arkeologjik në Dresnik dhe resurse të turizmit rural;rezerva të thëngjillit,boksiteve,argjilës,rërës,zhavorit,gurit ndërtimor për ndërtim dhe dekorim etj.**<br>• **Tokë pjellore për bujqësi,posaqërisht pjesa e tokës bujqësore që shtrihet në Rrafshin e Dukagjinit që përshkohet nga rrjedha fushore e lumenjëve dhe që me ndërtimin e ujënxënjeve(pendave) dhe kanaleve të ujitjes mund të ujiten mbi 2000 hektarë të tokës bujqësore.**<br>• **Niveli I zhvillimit të ndërmarrjeve te vogëla dhe të mesme (NVM-ve) dhe transferi gradual nga veprimtaritë tregtare dhe shërbyese kah veprimtaritë prodhuese ,bujqësore dhe ndërtimore (sipas zyrës se regjistrimit të bizneseve brenda 10 viteve kemi dyfishim te numrit te bizneseve).**<br>• **Infrastruktura fizike relativisht mirë e zhvilluar:Rrugët që lidhin Klinën me qytetet tjera si dhe ato që I lidhin lokalitetet dhe fshatrat me qendrën administrative të qytetit të Klinës janë asfaltuar;është përmirësuar rrjeti I shpërndarjes dhe furnizimi me energji elektrike,ndriçimi publik etj .**<br>• **Resurse njerëzore:Fuqi punëtore të** | • **Mos shfrytëzimi tokës bujqësore në mënyrë racionale: Zvogëlim I vazhdueshëm I sipërfaqeve të ngastrave bujqësore që kufizojnë mundësinë e përdorimit te teknologjisë se avansuar bujqësore dhe masave tjera agroteknike në bujqësi.**<br>• **Mbështetje e pamjaftueshme për zhvillimin e NVM-ve:Mundësi te kufizuara për qasje në fonde zhvillimore,kushte të pavolitshme te kreditimit për shkak të normave te larta te kamatës, subvencionimi I pamjaftueshëmi farmerëve dhe masa te pamjaftueshme te mbrojtjes prodhimeve vendore.**<br>• **Zvogëlim I vazhdueshëm I fondit të tokës bujqësore për shkak të shëndërrimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore,me fjalë tjera menaxhim I pa përshtatshëm I tokës bujqësore.**<br>• **Mungesë e fuqisë punëtore të kualifikuar me përgatitje te mesme shkollore dhe arsim cilësor për profile te caktuara bujqësore dhe turizmit.**<br>• **Mos shfrytëzim I mjaftueshëm I potencialeve dhe resurseve te disponueshme për ujitjen e tokave bujqësore.**<br>• **Kapacitete te pamjaftueshme profesionale te infrastrukturës njerëzore në administratën komunale për përkrahje te bizneseve në sistemin e ekonomisë se tregut.**<br>• **Buxheti I pa mjaftueshëm komunal për një mbështetje me të madhe të bizneseve lokale dhe zbatimit të një Strategjie me efikase te zhvillimit ekonomik lokal (ZHEL-it).**<br>• **Traditë e pa mjaftueshme e konsumimit te produkteve vendore dhe mungesa e një nacionalizmi pak me te theksuar ekonomik** |

| | |
|---|---|
| **mjaftueshme dhe në masë të caktuar e përgatitur dhe e kualifikuar, me përgatitje të lartë profesionale.**<br>• **Kushte te mira për zhvillimin e blegtorisë në zona të caktuara të komunës ku ka sipërfaqe te kullotave si dhe bagëtive të imëta në viset malore (pyjore).**<br>• **Traditë e mirë e krijuar nëpër vite në kultivimin e perimeve nëpër kopshte sa I përket kultivimit të lakrës,specave,domateve ne fusha te hapura dhe sera të plastifikuara;rritje e numrit te bizneseve dhe traditës se krijuar për prodhimin e dyerve, dritareve dhe prodhimeve tjera nga plastika;rritja dhe tradita e krijuar për nxjerrjen dhe prodhimin e gurit për ndërtim dhe dekorim etj**<br>• | • **Mungesa e here pas hershme e energjisë elektrike.**<br>• **Migrimet e brendshme fshat-qytet dhe lënja djerrinë e sipërfaqeve te caktuara te tokave bujqësore.** |
| **Mundësitë**<br>• **Zhvillimi I bujqësisë si prioritet nacional dhe mundësia e përfitimit te granteve nga Agjencioni I zhvillimit të bujqsisë për farmerët klinas me bashkëfinacim për ngritjen e pemishteve,prodhimeve te imëta bujqësore;mundësia e zhvillimit të aktiviteteve te reja të prodhimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore.**<br>• **Përmirësimi i rrethanave dhe ambientit për biznes dhe krijimi I parakushteve për tërheqjen e investimeve te huaja dhe kapitalit nga diaspora locale:Ligji për investimet e huaja,Ligji për investimet strategjike, Agjencia për investime dhe perkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, Agjencia Kosovare për promovimin e investimeve të huaja,Pakoja e re fiskale.**<br>• **Përmirësimi I vazhdueshëm I infrastrukturës fizike në nivel vendi dhe inicimi I procedurave për sigurim të hapësirës për ngritjen e një parku të biznesit në komunën e Klinës.**<br>• **Organizimi dhe funksionimi më I mirë I komunitetit te biznesit:krijimi dhe funksionimi I Shoqatës se biznesit;përmirësimi dhe avansimi I shkathtësive për të bërit biznes përmes trajnimeve,pjesëmarrjes në panaire, promovime te produkteve vendore,vizita dhe udhëtime studimore.**<br>• **Rritja e nivelit të bashkëpunimit me** | **Rreziqet**<br>• **Kriza rajonale si rrjedhim I krizës globale dhe ndikimi negativ në tërheqjen e investimeve te huaja dhe përfitimit të donacioneve.**<br>• **Zbatim I pa mjaftueshëm I infrastrukturës ligjore,rezultate ende jot ë mira në luftë kundër korrupcionit dhe krimit ekonomik dhe nivel I brishte I zhvillimit te proceseve demokratike në vend.**<br>• **Ngecja e procesit te liberalizimit te vizave që kufizon dhe pengon lëvizjen e lirë të njerëzve dhe kapitalit.**<br>• **Konkurenca jolojale në treg për shkak të ekzistimit te ekonomisë joformale dhe evazionit fiscal.**<br>• **Pamundësia për çasje në tregjet e brendshme dhe jashtë vendit për plasimin e produkteve bujqësore.**<br>• **Efektet negative anësore të faktorit njerëzor mbi mjedisin tokësor si dhe ambientin e shëndetin publik.**<br>• **Tregu global dhe konkurenca:Presioni që ushtron konkurenca globale në ekonomitë e brishta nacionale në kushtet e pamjaftueshme të prodhimeve vendore**<br>• **Qasje e kufizuar në tregun rajonal për shkak të kufizimeve të lëvizjes se lirë të njerëzve dhe kapitalit dhe barrierave për depërtim në tregun evropian.**<br>• **Shkuarja jashtë e të rinjve me kualifikime te profileve caktuara për të punuar dhe** |

| | |
|---|---|
| **komunat fqinje, posaqërisht me ato të Regjionit Perëndimor përmes realizimit te projekteve te përbashkëta;shfrytëzimi I mundësive dhe ekspertizës profesionale që ofron Agjencia për zhvillim rajonal-regjioni Perëndim për promovim te investimeve,për zhvillim te transportit,turizmit etj.**<br>• **Rehabilitimi I zonave te degraduara: ripyllëzimi ,riciklimit të mbeturinave në nivel regjional;rregullimi I shtratit te lumenjve.** | **jetuar jashtë për shkak të joshjes nga kushtet me te mira të punës dhe jetës.** |

Rezultat apo rrjedhë logjike e diagnostifikimit dhe analizës SËOT është hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhen 2017-2021 e cila konsiston në:

- Përdorimin sa më optimal të përparësive të brendshme për zhvillimin ekonomik lokal,
- Eleminimi ose kapërcimi i dobësive të brendshme,
- Shfrytëzimi i të gjitha mundësive pozitive nga rrethina në nivel kombtar dhe ndërkombtar
- Neutralizimi i rreziqeve dhe sfidave që rrjedhin nga ndikimet e jashtme e të cilat nuk varen nga niveli lokal.

# IV. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2017-2021

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal është një proces i cili zhvillohet përmes përcaktimit të elementeve kyçe të strategjisë :Vizionit-synimeve-objektivave-programeve-projekteve.
Një strategji e mirë e zhvillimit ekonomik lokal është gjithëpërfshirëse , që fokusohet në një vizion të integruar për gjithë komunitetin dhe në disa synime dhe objektiva kyçe dhe që përcillet me plane veprimesh konkrete për realizimin e objektivave të caktuara.

## Vizioni i integruar për Komunen e Klinës

Pas diagnostifikimit dhe Sëot analizës , grupi punues me sugjerimet dhe pjesëmarrjen e grupeve të interesit ka përcaktuar Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Klinës për periudhen 2017-2021 si një Vizion të integruar , ka përcaktuar synimet dhe objektivat,ka identifikuar programet , projektet dhe planët e veprimit për realizimin e strategjisë.

# Vizioni

**Klina do të bëhet një vend ekonomikisht i zhvilluar,me një administratë komunale efikase në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe investuar.Duke patur për bazë pozitën dhe kushtet gjeografike , prioritet do të jetë zhvillimi i NVM-ve,bujqësisë,turizmit dhe infrastrukturës fizike.Do të kemi ngritje dhe përmirësim te cilësisë në arsim,shëndetësi dhe shërbime publike.**

## Zhvillimi i integruar ekonomik i Komunës së Klinës – problemet dhe sfidat e identifikuara zhvillimore

Problem i veçantë në çdo komunë është një qasje e integruar e zhvillimit ekonomik lokal dhe problemet kryesore ndërlidhen me:

- Zhvillimin jo adekuat dhe shkallën e lartë të papunësisë
- Mosshfrytëzimin adekuat të resurseve lokale dhe potencialeve për zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë.
- Shfrytëzimin joracional të tokës
- Ndërtimet në tokë bujqësore
- Qasjen e pamjaftueshme në fonde investuese (kamata e lartë, bankat investuese)
- Strukturën e ekonomisë, të drejtuar shumë nga veprimtaritë tregtare
- Strukturën e bizneseve private, orientimi me tregti, jo prodhim
- Orientimin e kapitalit nga jashtë
- Informimin jo të mjaftueshëm të bizneseve dhe qytetarëve për grante nga donatorët e ndryshëm për biznese të reja
- Moszhvillimin e turizmit rural

## Synimet për zhvillim të integruar ekonomik të Komunës së Klinës

Vizioni i komunës së Klinës është t'i gjej, identifikojë e t'i hulumtojë problemet dhe interesat e qytetarëve të Klinës, në të gjitha nivelet e jetës, me qëllim të përgatitjes së planeve zhvillimore përkatëse, me të cilat do të arrihet të plotësohen nevojat dhe interesat e qytetarëve , si :

- **Rritja e nivelit të zhvillimit ekonomik të komunës përmes promovimit të investimeve, zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, zonës industriale – parkut të biznesit, zhvillimit të bujqësisë ,zhvillimit të turizmit, etj.**
- **Përmirësimi i infrastruktures rrugore,infrastructures njerëzore-administrative dhe komunikuese, infrastrukturës hekurudhore , komunale etj.**
- **Ngritja e nivelit arsimor të popullatës dhe zhvillimi i resurseve njerëzore, përmes kualifikimit dhe rikualifikimit të fuqisë punëtore,përshtatje të arsimimit ndaj ekonomisë, nxitjes dhe zhvillimit te aktiviteteve kulturore ,sportivet dhe rekreacionit, etj.**
- **Sigurimi i një ambienti dhe mjedisit jetësor të shëndoshë përmes përmirësimit të shërbimeve shëndetësore, menaxhimit me efikas të hedhurinave të forta, ndërtimit të sistemit për pastrimin e ujrave të zeza , mbrojtjes së fondit të pyjeve dhe kafshëve të egra etj.**

Synimet do te përfshijnë të gjitha aktivitetet që do të kontribuojnë në realizimin e objektivave që do të mundësojnë që komuna e Klinës , të promovohet si vend atraktiv për jetë me sektor biznesi të zhvilluar, infrastrukturë më të mirë, krijim të kushteve për punësim të një numri më të madh njerëzish, qendër arsimore me kushte të avancuara për arsimim, mjedis të pastër shëndetësor e ekologjik me mundësi për përmirësim të mëtejshëm të kushteve për jetë cilësore të qytetarëve.
Në këtë drejtim, Synimet do të përfshijnë dhe stimulojnë të gjitha kapacitet pozitive në territorin e komunës së Klinës me një qëllim të përgjithshëm, për të mundësuar zhvillim dinamik e të qëndrueshëm mbi parimet e konkurrencës, inovacioneve dhe shfrytëzimit të teknologjive e diturive bashkëkohore.
Në bazë të të dhënave dhe analizave tona , vlerësojmë se theksi kryesor i zhvillimit të përgjithshëm të komunës së Klinës duhet të përqendrohet në Synimet vijuese zhvillimore:

**Synimi nr.1- Zhvillimi ekonomik;**
**Synimi nr.2- Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve**
**Synimi nr.3- Përmirësimi i cilësisë se arsimit dhe shëndetësisë;**
**Synimi nr.4- Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.**

# 1. Zhvillimi ekonomik

Zhvillimi ekonomik si segment i rëndësishëm i zhvillimit të përgjithshëm te komunës se Klinës zënë vendin parësor për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve, kurse me këtë edhe në Strategjinë tonë për zhvillimin e Komunës së Klinës.
Në bazë të Analizës SËOT përkatësisht analizës se përparësive krahasuese (komparative) për sa i përket Zhvillimit ekonomik të komunës se Klinës ,konsiderojmë se sektorët me të rëndësishëm që do të kenë ndikim (impakt) të drejtëpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe që njëherit do të jenë si objektiva të pritëshme të Strategjisë se Zhvillimit ekonomik te komunës se Klinës për periudhën e ardhshme afatmesme 2017-2021 janë:

- **Ndërmarrësia – Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ;**
- **Zhvillimi i bujqësisë;**
- **Zhvillimi i turizmit dhe trashegimisë kulturore.**

Prandaj, vëmendjen tonë do ta përqendrojmë pikërisht të këto objektiva strategjike.

## Ndërmarrësia-Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Niveli i zhvillimit ekonomik te një vendi matet me nivelin e zhvillimit të ndërmarrjeve te vogëla dhe të mesme të cilat janë promotor të zhvillimit ekonomik, në njërën anë dhe uljen e shkallës se papunësisë,në anën tjetër.Në këte drejtim,rol të rëndësishëm luajnë politikat e qeverisjes lokale për nxitjen dhe zhvillimin e ndërmarrësisë .Për këte qëllim duhet adaptuar politikat dhe programet vijuese të cilat ndikojnë për një zhvillim me të hovshëm të ndërmarrësisë dhe NVM-ve:

- **Përmirësimi i vazhdueshëm i rrethinës afariste dhe ambientit të të bërit biznes**
- **Krijimi i kushteve dhe infrastrukturës ligjore për mundësuar caktimin e lokacionit dhe investimet në përgatitjen e infrastruktures fizike te Parkut te Biznesit**
- **Krijimi i një sektori të veçante në kuadër të administratës komunale për ZHEL .Ky sektor do ofronte ndihmë administrative dhe profesionale për NVM-të dhe do të merrej me Zbatimin e Strategjisë se zhvillimit ekonomik të komunës se Klinës.**
- **Krijimi i bazës ligjore për stimulim të ndërmarrjeve të reja, veçanërisht atyre prodhuese dhe atyre që krijojnë vende të reja të punës**
- **Lehtësimi i mëtutjeshëm i procedurave administrative rreth regjistrimit të ndërmarrjeve të reja**
- **Qeveria lokale të marr iniciativë dhe të krijoj kushte rreth formimit të Shoqatës së biznesit e cila do të jap këshilla dhe ide rreth zhvillimit të biznesit duke ndikuar direkt si urë lidhëse në mes të bizneseve dhe qeverisë locale dhe duke përfaqesuar interesat dhe kërkesat e bizneseve në raport me administratën komunale.**
- **Krijimi i një fondi zhvillimor për përkrahjen e NVM-ve**

### Identifikimi i sektorëve prioritar të orientimit të investimeve të NVM-ve

Bazuar në studimet dhe analizat e tokës bujqësore dhe duke patur parasysh faktin e identifikimit te zhvillimit te bujqësisë si një prej synimeve kryesore të Strategjisë se zhvillimit ekonomik të Komunës se Klinës që del nga Analiza SËOT e konsiderojmë prioritet të lartë orientimin e investimeve në periudhën e ardhshme afatmesme në bujqësi.
Nga ana tjetër,kjo përputhet edhe prioritetet e qeverisë nacionale pasi që edhe në nivel qendror bujqësia konsiderohet prioritet nacional,prandaj konform kësaj investimet në zhvillimin e bujqësisë në komunën e Klinës do të orientohen në sektorët e mëposhtëm,por nuk do të kufizohen vetëm në to por edhe në sektorët që Ministria e bujqësisë I konsideron prioritare sipas viteve dhe te cilat i mbështet dhe përkrah në aspektin financiar përmes fondeve zhvillimore.Në bujqësi janë identifikuar si sektor prioritar :

- **Përkrahja,mbështetja dhe inkurajimi për krijimin e NVM-Ve për prodhimin dhe përpunimin e frutave të imëta bujqësore;**
- **Përkrahja,mbështetja dhe krijimi i kushteve për ngritjen e pemishteve të reja , përkatësisht NVM-ve që merren me kultivimin e pemëve frutore.Përkrahja nga qeveria**

**lokale për këte sektor ka të bëj me dhënjen e fidaneve të ndryshme të pemëve për farmerët lokal ,ndërsa nga ana e Ministrisë se bujqësisë përmes dhënjës se fondeve zhvillimore për ngritjen e pemishteve të llojeve te ndryshme sipas prioriteteve te përcaktuara nga Ministria.**

- **Përkrahja ,mbështetja dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e blegtorisë për prodhim te qumështit,mishit etj.Në zona të caktuara malore duhet nxitur dhe përkrahur bujqit për zhvillimin e blegtorisë se kafshëve te imëta:deleve,dhive etj**

Gjatë disa viteve të fundit në komunën e Klinës është identifikuar edhe një sektor i rëndësishëm:Prodhimi i gurit për ndërtim dhe për dekorim në regjionin e Gllarevës dhe Rixhevës.Prandaj për të nxit një zhvillim edhe me te madh të kësaj veprimtarie duhet punuar më shumë sa i përket:

- **Promovimit vendor, e mundësisht edhe ndërkombëtar, të produkteve të gurit ndërtimor dhe dekorativ. Sektori i ZHEL-it në bashkëpunim me ekzekutivin dhe shoqatën e biznesit të shikojnë mundësitë për plasimin e produkteve në tregun e brendshëm dhe në ate të jashtëm përmes eksportit.Në sferën e promovimit dhe marketingut të këtyre produkteve është e mundur të bëhet me shumë duke organizuar ndonjë panair apo ndonjë manifestim të llojit si "Dita e gurit ndërtimor dhe dekorativ".**

  **Sa i përket investimeve të huaja,kjo është shumë e lidhur me gjendjen e përgjithshme që ekziston në Kosovë dhe mundësitë që komuna të bëj me shumë në këte drejtim janë të kufizuara,me gjithë ate komuna duhet të angazhohet për**

- **Krijimin e mundësive për tërheqjen e investimeve të huaja dhe kapitalit të diasporës lokale përmes lehtësive të caktuara për aq sa ofron legjislacioni dhe infrastruktura ligjore ekzistuese për këte qëllim.Një rast i mirë i ofrimit të këtyre lehtësive do të ishte sigurimi i lokacionit(hapësirës) për zhvillimin e biznesit në Parkun e biznesit,thjeshtësimet e procedurave administrative dhe lejeve komunale.Këto masa shkojnë paralel edhe me masat që ndërmerr Qeveria qendrore në nivel nacional.**

  Një opsion i mundshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve te vogëla dhe te mesme është edhe

- **Krijimi i një fondi zhvillimor për përkrahjen e NVM-ve.Por në rast të kundërt,nëse krijimi i këtij fondi në nivel komunal do të jetë i pamundshëm për shkak të kufizimeve buxhetore ,atëherë kjo do të kompenzohej me asistencën e administratës komunale,e veqmas sektorit të ZHEL-it për qasje në fonde zhvillimore të nivelit qendror dhe organizmave e organizatave ndërkombtare që japin fonde për zhvillim ekonomik në Kosovë.**

Në fund , të themi edhe këte: Krijimi i kushteve të domosdoshme për zhvillim më të shpejtë të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, është parakushti kryesor i zhvillimit ekonomik te komunës dhe krijimit të klimës së volitshme të biznesit. Me përmirësimin e kushteve të zhvillimit do të mundësohet rritje e numrit të NVM-ve, përmirësim i cilësisë së prodhimeve dhe shërbimeve, zgjerim i kapaciteteve

prodhuese, investime të reja, zvogëlim i shkallës së papunësisë dhe në fund të fundit edhe mirëqenje dhe standard me i lartë jetësor etj.

## Zhvillimi i bujqësisë

Pozita gjeografike , toka e pjellore, kushtet e volitshme klimatike, pasuritë e kullotave dhe pyjeve, përqindja e lartë e popullësisë në zonat rurale janë indikatorë të mjaftueshëm që komunën e Klinës e bëjnë një vend atraktiv për zhvillimin e bujqësisë dhe vet zhvillimin e bujqësisë si njërin ndër sektorët kryesor dhe bartës I zhvillimit ekonomik të komunës së Klinës në periudhën e ardshme afatmesme 2017-2021.
Nga ana tjetër bujqësia është një nga degët më të rëndësishme të zhvillimit ekonomik në Komunën e Klinës dhe do te jetë edhe në të ardhmen.Kushtet e përshtatshme dhe klima, sidomos në pjesën e luginës se Dukagjinit, e bëjnë këte pjesë,regjion ideal për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore. Duke patur parasysh se ky regjion ka një furnizim të mjaftueshëm me ujë ,mundësitë për ujitjen e tokave bujqësore ende ka mundësi te shtohen nga 1530 hektarë sa ujiten sot deri në 2000 hektarë dhe njëkohësisht edhe rendimentet e prodhimeve bujqësore,pasi që sipas analizave ujërat për ujitje përmbajnë gëlqere që këtyre tokave u nevojitet se ato përmbajnë pak gëlqere.Këto toka janë me të përshtatshme për prodhimin e panxhar sheqerit dhe bimëve leguminoze: fasules,bizeles por edhe te lashtave:grurit dhe misrit.Prej perimeve tradicionalisht kultivohen mbillen speca, domate, tranguj, patate, qepë, hudra, shalqi, dhe lakër. Të gjitha këto produkte janë mbjellë kryesisht për nevoja familjare dhe shumë pak për tregëti.Lakra më së shumëti mbillet në fshatin Gremnik i cili është shumë i njohur për cilësinë e lakrës jo vetëm komunën e Klinës, por edhe me gjerë.Sa I përket pemtarisë dhe kultivimit te frutave ,Komuna e Klinës nuk ka ndonjë traditë të zhvilluar për kultivimin e tyre dhe më shumë kultivohen pemishtet ne kopshte dhe oborre dhe kryesisht për nevoja familjare.Më së shumëti kultivohen mollët ,kumbullat,dardhat por analizat kanë kanë treguar se kjo zonë ka kushte shumë të përshtatshëm për kultivimin e qershisë, pjeshkës, kajsisë ,lajthisë, arrave dhe frutave të imëta:manaferrave ,luleshtrydheve, mjedrës, rrushit etj Sipas disa studimeve që janë bërë nga ekspertët e bujqësisë në territorin e kësaj komune në luginën e Drinit të Bardhë dhe lumit të Pejës ekzistojnë kushte te volitshme për prodhimin e bimëve industrial dhe bimëve për prodhim te ushqimit te kafshëve prej te cilave mund te priten rendimente te mira.Ndërsa në zonat kodrinore ka kushte te mira për kultivimin e frutave ,por nuk ka ndonjë traditë të kultivimit te tyre,përveq për nevoja familjare.
Për sa I përket pyjeve dominojnë pyjet e dushkut dhe shkurret dhe janë në mjë gjendje jo të mirë.Pjesa me e madhe janë pyje me produktivitet te ultë dhe jot e menaxhuara mire, gjendja e tyre nga këndvështrimi ekonomik është e pakënaqshme për shkak cilësisë se ultë te pyjeve dhe periudhës se gjatë te riprodhimit.

Sipas karakteristikave te relievit të komunës, Klinan dahet në tri zona:

1. **Zona malore me potenciale te ulëta për zhvillimin e bujqësisë me pyje që kanë produktivitet te ulët të drunjve te cilët kryesisht shfrytëzohen si dru zjarri**
2. **Zona kodrinore me sipërfaqe heterogjene dhe toka pjesërisht të mira për prodhim e te lashtave dhe blegtorisë dhe**
3. **Luginat e lumenjve me toka pjellore me mundësi ujitjeje dhe potenciale te mira për prodhimtari intensive bujqësore**

Ndërsa sa i përket masave prioritare dhe sektorëve prioritar për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë për periudhën e ardhshme afatmesme 2017-2021 duhet ndërmarrë aktivitetet që bëjnë të mundur:

- **Rritjen e rendimenteve bujqësore që mund të arrihet me përdorimin e farërave dhe fidaneve cilësore,sorteve te reja,aplikimit te masave te reja agroteknike dhee mekanizmit të avansuar bujqësor, si dhe duke përmirësuar sistemin e ujitjes se tokave bujqësore;**
- **Trajtimi i ujërave të zeza dhe pengimin e derdhjes se ujrave te zeza në kanalet e ujitjes që të mos ndoten sipërfaqet e tokave bujqësore (është nevojshme të bëhen zgjidhje për te penguar ndotjen e lumenjve sidomos te lumit Drini Bardhë, Klina dhe Lumit te Pejës-Lumbardhit pë r te mos lejuar shkarkimin e ujërave të zeza të papërpunuara në rrjedhën e tyre).**
- **Ndalimi i ndërtimeve në tokat bujqësore –Të ndërmirren masa me qëllim te ruajtjes se fondit te tokës bujqësore dhe te ndërpritet trendi transferit te tokes bujqësore në tokë ndërtimore duke u bazuar në planin zhvillimor komunal dhe legjislacionin ekzistues për këte lëmi**
- **Marketingu i produkteve bujqësore-Për rritjen e prodhimit bujqësor dhe tregut të prodhimeve bujqësore duhet ndërmarrë hapa për promovimin e prodhimeve bujqësore përmes organizimit te formave te ndryshme te marketingut :organizimi I panaireve në nivel komunal dhe pjesëmarrja në panaire,fletushkat,broshurat etj**
- **Organizimi i grupeve të fermerëve me interes të përbashkët-Inkurajimi i fermerëve për t'u bashkuar në projekte te caktuara me interes te përbashkët me qëllim të përfitimit të fondeve për zhvillim të bujqësisë si prodhuesit e qumështit,mishit,frutave etj**
- **Vendndodhja në udhëkryq të vendit- Kopshti i Kosovës –Shfrytëzimi I pozicionit te volitshëm gjeografik dhe kushteve te volitshme për bujqësi ,lidhjeve te mira dhe rrjetit të rrugëve që e lidhin Klinën me qendrat (qytetet) tjera te Kosovës.**
- **Ekzistenca e objekteve të trashëguara –Klina ka trashëguar Fabrikën e farërave dhe ushqimit te kafshëve te cilat me një veprim me te kordinuar do të mund të shërbenin si infrastrukturë e mirë për zhvillimin e bujqësisë**
- **Kultivimi i pëmeve të imta-Analizat kanë kanë treguar se në teritorin e komunës se Klinës ka kushte te volitshme për kultivimin e frutave të imëta:manaferrave ,luleshtrydheve, mjedrës, rrushit etj,por edhe pemëve tjera si: qershisë, pjeshkës, kajsisë ,lajthisë, arrave etj si dhe mundësia e përpunimit te tyre në kapacitetet prodhuese në Klinë,përkatësisht Fabrikën e prodhimit te ëmbëlsirave "AMO" në Klinë;**
- **Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i pyjeve-Per të rritur produktivitetin e pyjeve,për të mbrojtur ambientin dhe pyjet nga degradimi,për të mbrojtur tokat bujqësore nga erozioni dhe një ekosistem te balancuar ekologjik në periudhën e ardhshme duhet bërë ripyllëzimin e sipërfaqeve te xhveshura dhe pyllëzimin e sipërfaqeve të reja te pyjeve.**
- **Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe arsimit bujqësor-Duke e konsideruar bujqësinë si njërën prej degëve me të rëndësishme te zhvillimit në komunën e Klinës do të jetë e nevojsshme që Drejtoria e bujqësisë dhe zhvillimit rural në bashkëpunim me Drejtorinë e arsimit të planifikojnë hapjen e profileve bujqësore në shkollën e mesme profesionale me qëllim të krijimit te kuadrit te nevojshem të profileve te caktuara bujqësore sipas kërkesave të tregut te punës.**

- **Përkrahja dhe mbështetja e bujqëve përmes formave të caktuara të subvencionimit të farmerëve për prodhimet e tyre bujqësore.**

## Zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore

Komuna e Klinës ka potencial për zhvillimin e turizmit rekreativo-turistik. Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë "Ujëvarat e Mirushës" është park që paraqet një fenomen të rrallë natyror me rëndësi të veçanet natyrore, shkencore, kulturore dhe turistike.. Realizimi i këtij qëllimi strategjik, është kusht i rëndësishëm për plotësimin e vizionit dhe misionit të zhvillimit të përgjithshëm të Komunës së Klinës.

- **Investimet në parkun Ujëvarat e Mirushës (ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë,ndërtimi i teleferikut mbi rrjedhën e ujëvarave te Mirushës)**
- **Investimi në Grykën e Lumit Klina (Trasimi i shtigjeve për këmbësor për vizitorët e kësaj gryke te lumit)**
- **Promovimi i lokalitetit arkeologjik në Dresnik (ndërtimi i rrugës dhe shtigjeve për qasje të vizitorëve të lokalitetit arkeologjik)**
- **Agro turizmi rural (shfrytëzimi i potencialeve natyrore për zhvillimin e turizmit rural,pranë rrjedhës se lumenjve,në pjesën ndërmjet tuneleve ne Pograxhë etj).**
- **Rritja e sipërfaqeve te gjelbëruara dhe krijimi i miniparqeve, përkatësisht hapësirave dhe zonave te gjelbërta në pjesë të ndryshme te qytetit;**
- **Themelimi i një pike të informimit turistik (brenda administrtatës komunale të jetë një pikë referuese dhe një person,bie fjala zyrtari komunal për trashëgimi kulturore që do të ofroj informata lidhur lokalitetet dhe objektet turistike në komunë).**

Klina me rrethinë është e pasur me lokalitete arkeologjike me objekte të shumta të trashëgimisë kulturore si: Kulla dhe ura , mullinjë , objekte te kultit: xhamia , kisha mesjetare , kisha katolike , tyrbe etj. si përparësi krahasuese për zhvillimin e turizmit.Prandaj në këte drejtim orientimet prioritare do të kenë për qëllim:

- **Ruajtjen, mirëmbajtjen,renovimin, dhe konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore**
- **Promovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore**
- **Promovimi dhe organizimi i ditëve të trashëgimisë kulturore ( veshjeve kombëtare dhe prodhimeve te artizanatit vendor).**
- **Bashkëpunimi me Ministrinë e kulturës,rinisë dhe sportit në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe me qëllim të përdorimit të tyre si vlera turistike, arkeologjike, historike, shkencore dhe arsimore;**

Në kuadër te veprimtarisë kulturore dhe bibliotekare ,veprime me prioritet ne periudhën afatmesme duhet te jenë:

- **Rritja dhe pasurimi i fondit të librave në biblioteke**
- **Renovimi i sallës për lexues**
- **Digjitalizimi i fondit të librave në biblioteke**

Komuna është duke punuar vazhdimisht në rregullimin dhe e këtyre trashëgimive kulturore dhe synon që në një periudhë më të gjatë kohore në bashkëpunim me MKRS dhe institucienet tjera relevante që këto trashëgimi kulturore të jenë të mbrojtura, për t'u përdorur si vlera turistike, arkeologjike, historike, shkencore, arsimore etj.

# II. Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve

Lidhjet e mira komunikuese, lidhja infrastrukturore, lehtësimi i qasjes dhe lëvizja janë me domethënie të veçantë, për zhvillimin e ekonomisë. Prandaj zhvillimi i infrastrukturës , si një segment i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Komunës së Klinës , zë vend në këtë plan strategjik duke u përqendruar në këto objektiva:

- **Rritja e nivelit të shërbimeve administrative për biznese (reduktimi i procedurave)**
- **Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra**
- **Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në fshatra**
- **Zgjerimi i infrastrukturës rrugore**

Politikat lokale për sa i përket zhvillimit dhe zgjerimit të mëtejshëm të infrastukturës (fizike dhe njerëzore) bazohet në këto prioritete dhe objektiva:

**-Përmirësimi i të gjitha shërbimeve administrative për të gjithë qytetarët e Komunës se Klinës e posaqërisht Ndërmarrjet e vogëla dhe të mesme.Kjo nënkupton ngritjen e nivelit dhe cilësisë se infrastrukturës njerëzore në administratën komunale,nivelit dhe cilësisë se arsimit dhe shërbimeve publike në përgjithësi;**

**-Reformimi i vazhdueshëm i administratës komunale me qëllim të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarë dhe biznese;**

**-Përmirësimi i lidhjeve infrastrukturore me qendrat dhe komunat fqinje të Klinës;**

**-Formimi dhe urbanizimi i lagjeve të reja në qytet bazuar në legjislacionin ekzistues në nivel lokal e qendror dhe planifikimit hapësinor mbi bazën e Hartave zonale komunale;**

**-Shkarkimi i komunikacionit në qendrën e qytetit të Klinës përmes ndërtimit të rrugëve anësore repektivisht krijimit të unazave që do ta shkarkojnë dhe lehtësojnë qarkullimin e automjeteve dhe qytetarëve në brendinë e qytetit;**

**-Përmirësimi dhe zgjerimi i mëtejshëm i rrugëve në fshatra dhe lagje te fshatrave për lehtësim të lidhjeve me qendrën komunale dhe anasjelltas;**

**-Zgjerimi i rrjetit te ujësjellësit,kanalizimieve,ndriqimit publik dhe grumbullimit te mbeturinave që do te ndikoj në rritjen e mirëqenjes se përgjithshme dhe ambientit jetësor.**

**Shënim**:Në Aneks të kësaj Strategjie te Amëza e projekteve janë identifikuar Projektet konkrete që kanë për qëllim realizimin e objektivave të mësipërme.

# III. Përmirësimi i cilësisë se arsimit dhe shëndetësisë

## ARSIMI

Komuna është përgjegjëse për sistemin arsimor parashkollor,parafillor,fillor dhe arsimin e mesëm.Strategjia dhe politikat arsimore që parashihet të zhvillohen në periudhën e ardhshme afatmesme e te cilat do të jenë në funksion jo vetëm të gjithëpërfshirjes por edhe te rritjes se cilësisë në arsim,do të përqendrohen në objektivat vijuese:

- **Përfshirja e gjithë fëmijve në institucionet e arsimit parashkollor dhe shkollor dhe kujdesi i vazhdueshëm ndaj fëmijëve dhe personave më nevoja të veçanta**
- **Përmirësimi i infrastrukturës fizike në arsim-Ndërtimi i shkollave të reja,rritja e hapësirës shkollore nëpër shkolla përmes ndërtimit të anekseve shkollore (ku ka nevojë) për mësim gjithëditor dhe një salle për trajnimin e personelit arsimor ne shkollën "Motrat Qiriazi" në Klinë**
- **Renovimi i shkollave – Rregullime te brendshme te shkollave,te kulmeve,te fushave sportive,te nyjeve sanitare, të nxemjeve qendrore ekologjike, rrethojave të shkollave,te pajisjeve shkollore, kabineteve, mjeteve didaktike ,gropave septike etj sipas nevojave dhe kërkesave që i ka në dispozicion Drejtoria e Arsimit për secilën shkollë veq e veq ;**
- **Krijimi i hapësirave-"oazave te gjelbërta" në mjediset shkollore të cilat përveq që krijojnë një ambient me të mirë në aspektin vizuel në të njëjtën kohë ndikojnë që te kemi një ambient me te pastër dhe me të shëndoshë nëpër shkolla.**
- **Përgatitja dhe krijimi i kushteve dhe hapësirës fizike nëpër shkolla për organizimin e mësimit gjithëditor dhe kurrikulës bazë (bërthamë);**
- **Planifikimi dhe hapja e profileve të reja mësimore në Shkollën e mesme profesionale për nevojat e ekonomisë dhe sipas kërkesave të tregut të punës.Është nevojë e ngutshme hapja e profileve bujqësore duke qenë se Analiza SËOT ka nxjerrë në pah bujqësinë si njërën nga degët prioritare për zhvillimin ekonomik të Klinës.**
- **Aktivitetet arsimore në terren për përvetësim të shkrim-leximit fillestar.Duke qenë se të Përshkrimi I gjendjes ekzistuese është konstatuar se në komunën e Klinës ka një përqindje të caktuar te qytetarëve që nuk dinë shkrim lexim edhe kësaj kategorie duhet siguruar qasje për përvetësim të shkrim-leximit.**

- **Avancimi i vazhdueshëm i cilësisë në nivelet e arsimit ( 0, 1, 2, 3 ) dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve në frymën e trendëve bashkëkohore;**
- **Pajisja e shkollave me mjete mësimore, literature dhe burime tjera mësimore e didaktike;**
- **Vendosja e kamerave të sigurisë, fillimisht në shkollat e qytetit ku ka numër më të madhë të nxënësve për rritjen e nivelit të sigurisë nëpër shkolla**
- **Aktivizimi i grupeve ekologjike nëpër shkolla**

Shënim:Projektet e veqanta te idendifikuara nga grupet e interesit për lëminë e arsimit e që kanë për qëllim realizimin e objektivave në sektorin e arsimit në periudhën afatmesme janë dhënë në Aneksin dhe Amzën e projekteve, në fund te kësaj Strategjie.

## SHENDETËSIA

Objektivat në zhvillimin dhe avansimin e shërbimeve shëndetësore në periudhën e ardhshme afatmesme dhe prioritetet e identifikuara:

- **Ngritja e infrastrukturës shendetësore-Ndërtimi i kapaciteteve të reja të infrastrukturës shëndetësore :**

  **-Renovimi ,pajisja dhe funksionalizimi i Urgjencës pranë QKMF-Klinë (viti 2017)**
  **-Ndërtimi i Ambulancës në Këpuz dhe Përqevë (viti 2018-2019)**
- **Përmirësimi i nivelit të shërbimeve shëndetësore:**

  **-Rritja e numrit të mjekëve të mjekësisë familjare për nevojat e shëndetësisë primare në Klinë për të arritur standardin 1 mjek për 2000 banorë ,te numrit te stomatologëve sipas standardit 1 stomatolog për 6000 banorë dhe numrit te mjekëve pediatër të cilët qysh tani i mungojnë Klinës;**

  **-Përmirësimi i nivelit të organizimimit të brendshëm te shërbimeve shëndetësore dhe çvendosja e stafit nga qendra në periferi;**

  **-Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i stafit shëndetësor dhe planifikimi i nevojave për mjek te profileve te caktuara pasi që Klina për dy deri ne tre vjet ka mundësi te ngel pa mjek pediatër;**

  **-Zhvillimi i projektit te digjitalizimit të shërbimeve shëndetësore;**

  **-Inicimi i trajnimit te personelit shendetësor për Sistemin informativ shëndetësor (SISH) dhe për menaxhimin e fondeve te sigurimeve shëndetësore;**

  **-Riorganizimi strukturor i shërbimeve shëndetësore në nivel komunal sipas një skeme te re funksionale që do të rris cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe ofrimin e shërbimeve shëndëtësore sa më afër qytetarit duke bërë funsionalizimin Qendrave te mjekësisë familjare në lokalitete dhe fshatra.**

# IV. Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor

Një ndër kushtet më kryesore për ngritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve është , përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor,prandaj si njëri prej synimeve te rëndësishme ka zënë një vend të posaçëm eedhe në Strategjinë për zhvillimin e Komunës së Klinës. Çdo njeri ka të drejtë të jetojë në mjedis të shëndoshë dhe të pastër ekologjik, njëkohësisht t'i ndiej edhe të mirat e saj. Gjithashtu, ka obligim ta ruaj dhe ta mirëmbajë mjedisin e këtillë jetësor. Ky është obligimi ynë drejt një ardhmërie të shëndoshë.

Objektivat e mbrojtjës së mjedisit janë:

- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta për koke banori
- Ndërtimi i miniparqeve në qytet
- Mundësimi i aktivizimit të Skemës Riciklim-ripërdorim dhe reduktim te mbeturinave
- Hartimi dhe zbatimi i masave nga plani lokal për mjedis

**PRIORITETET E IDENTIFIKUARA DHE OBJEKTIVAT E SHOQËRISË CIVILE SA I PËRKET INFRASTRUKTURËS FIZIKE / LIGJORE**

Njëra prej grupeve të interesit që ka kontribuar në përgatitjen e Strategjisë se zhvillimit ekonomik te komunës se Klinës është edhe shoqëria civile përkatësisht organizatat joqeveritare të cilat pos që plotësojnë zbrastësirën të cilën nuk e mbulon administrata dhe qeverisja locale, poasht u OJQ-të kanë nevoja dhe kërkesa me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë dhe funksionit të tyre në shoqëri.Nga ky aspect OJQ-të kanë përcaktuar objektivat vijuese :

1. Krijimi i mundësive për persona me aftësi të kufizuar për të pasur qasje fizike në të gjitha institucionet publike në territorin e komunës së Klinës;
2. Krijimi i mundësive për organizatat e shoqërisë civile për të pasur hapësirë fizike të organizimit dhe veprimit ( të ndara në zyre- Qendra Rinore):
3. Të shfrytëzohen shërbimet dhe asistenca që mund të ofroj Zyra për përgatitje te projekteve në nivel regjioni për planifikimin dhe përgatitjen e projekteve të caktuara;
4. Planifikimi i një fondi për mbështetje të personave ne aftësi të kufizuara:
5. Planifikimi i një fondi për mbështetje të Organizatave të Shoqërisë Civile:
6. Planifikimi për mundësinë e Ndërtimit të Ngrohtorës së qytetit.

## REZULTATET DHE EFEKTET QË PRITEN NGA ZBATIMI I STRATEGJISË SË ZHEL-it

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik do të ndikojë për një ekonomi të qëndrueshme lokale . Nga viti 2021, në Komunën e Klinës do të shihni një avancim në të gjitha fushat strategjike zhvillimore.Me zbatimin e kësaj strategjije , me zbatimin e synimeve , objektivave, aktiviteteve sipas strategjisë , rezultatet do të jen të dukshme në të gjitha fushat si :

Rritja e numrit të NVM rreth 5 %
Krijimi i rreth 200 vendeve të reja të punës në sektor të ndryshem
Rritja e numrit të të punsuarve rreth 10%
Zvoglim i shkallës së papunësisë për rreth 3.5%
Rritja e kapaciteteve prodhuese në sektorin e bujqësisë rreth 40%
Rritja e të ardhurave në sektorine bujqësisë dhe turizmit për rreth 100 familje
Përmirësimi i cilësisë së prodhimeve bujqësore
Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarve për rreth 50%
Përmirësimi i bazës shëndetësore për rreth 30%
Përmirësimi i arsimit
Reduktimi i kohës së udhtimit midis Qytetit dhe fshatrave më të pakten 30% .
Ulje me 30% e papastërtive në lumenj
Ulje me 50% e vengrumbullimeve të jashtligjshme të mbeturinave , thënë shkurt
Rritje e mirëqenjës dhe standardit jetësor për 30% .

## PROJEKTET QË SYNOHET TË REALIZOHEN GJATË PERIUDHËS 2017-2021

Bazuar në vizionin , synimet dhe objektivat e sipërpërmendura , Komuna e Klinës ka identifikuar projektet në funksion të përmirësimit të zhvillimit ekonomik për periudhen afatmesme 2017-2021 , siq janë :

| Nr. | Emërtimi | Vlera |
|---|---|---|
| 1 | Kanalizimi në Gjurgjevik të madh | 100,000.00 |
| 2 | Kanalizimi në Zllakuqan | 70,000.00 |
| 3 | Asfaltimi i rrugës në Krushevë të madhe | 120,000.00 |
| 4 | Asfaltimi i rrugës në Jashanicë | 150,000.00 |
| 5 | Kanalizimi në Dush të Sferkës | 50,000.00 |
| 6 | Asfaltimi i rrugës në Deiq | 80,000.00 |
| 7 | Kanalizimi në Kernicë | 150,000.00 |
| 8 | Ujesjellësi në Qabiq | 100,000.00 |
| 9 | Asfaltimi i rrugës në Shtupel | 80,000.00 |
| 10 | Asfaltimi i rrugës në Kpuz | 100,000.00 |
| 11 | Asfaltimi i rrugës në Zajm | 60,000.00 |
| 12 | Kanalizimi në Zabergjë | 100,000.00 |
| 13 | Kanalizimi në Resnik | 80,000.00 |
| 14 | Asfaltimi i rrugës në Stupë | 80,000.00 |
| 15 | Kanalizimi në Bokshiq | 100,000.00 |
| 16 | Asfaltimi i rrugëve në Qupevë | 100,000.00 |
| 17 | Asfaltimi i rrugës Jashanicë - Shtupel | 420,000.00 |
| 18 | Asfaltimi i rrugës Stupë - Grabanicë | 2,800,000.00 |
| 19 | Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës tranzit Gremnik - Klinavc | 2,000,000.00 |
| 20 | Asfaltimi i rrugës Perqevë -Sferkë | 400,000.00 |
| 21 | Kanalizimi në Gjurgjevik të vogël | 60,000.00 |
| 22 | Ndërtimi i trotuareve | 50,000.00 |
| 23 | Ndërtimi me gurë i Sheshit | 731,000.00 |
| 24 | Asfaltimi i rrugës në Pogragjë | 150,000.00 |
| 25 | Kanalizimi në Pataqan | 40,000.00 |
| 26 | Asfaltimi i rrugës Kpuz-Qeskovë | 100,000.00 |
| 27 | Asfaltimi i rrugëve në lagje të qytetit | 200,000.00 |
| 28 | Kanalizimi në Siqevë | 100,000.00 |
| 29 | Hartat zonale | 50,000.00 |
| 30 | Kanalizimi në Jashanicë | 10,000.00 |
| 31 | Ndërtimi i stacionit të autobusve | 300,000.00 |
| 32 | Ndërtimi i rrethrrotullimit të Sheshi Ndue Perlleshi | 30,000.00 |
| 33 | Asfaltimi i rrugëve lokale në Drenoc | 50,000.00 |

| | | |
|---|---|---|
| 34 | Asfaltimi i rrugëve lokale në Poterq | 50,000.00 |
| 35 | Kanalizimi në Radulloc | 100,000.00 |
| 36 | Ndërtimii i zyrës së gjendjës civile në Gllarevë | 50,000.00 |
| 37 | Ndërtimii i zyrës së gjendjës civile në Ujmirë | 55,000.00 |
| 38 | Rregullimi i zyrës për kunorëzime | 5,000.00 |
| 39 | Vendosja e një E-KIOSKU për shërbimet e gjendjës civile | 10,000.00 |
| 40 | Avansimi i shërbimit të printimit në pay për print | |
| 41 | Lidhja në rrjetin fibër optik ndërmjet QK,QPS,QKMF,QKRC dhe ZP | 5,000.00 |
| 42 | Përmirësimi I komunikimit të brendshëm me Sëitch Cisco POE +24 porta | 500.00 |
| 43 | Ngritja e një qendre trajnuese për nevojat e administratës në fushen e TI | 6,500.00 |
| 44 | Zhvillimi i një softveri për menagjimin e autoparkut | 3,000.00 |
| 45 | Kanali i ujitjës në Zllakuqan- Radulloc | 30,000.00 |
| 46 | Kanali i ujitjës në Kpuz | 15,000.00 |
| 47 | Kanali i ujitjës në Grabanicë - Zajm - faza e parë | 35,000.00 |
| 48 | Kanali I ujitjës në Jagodë | 190,000.00 |
| 49 | Kanali i ujitjës në Dollovë | 18,000.00 |
| 50 | Furnizimi me fidane për pemë të imta si : mjederr, dredhëz dhe manaferrë | 85,000.00 |
| 51 | Ndërtimi i pikës grumbulluesetë qumshtit në Sferkë | 30,000.00 |
| 52 | Furnizim me koshere bletësh | 10,000.00 |
| 53 | Furnizim me mekanizem bujqësor si : autokombanjë për zhveshje të misrit, motokultivator, mbjellëse për qepë etj. | 100,000.00 |
| 54 | Furnizim me makina mjelëse | 40,000.00 |
| 55 | Ndertimi i serave | 30,000.00 |
| 56 | Ndertimi i pendës dhe kanalit të ujitjës në Drenovc , Pjeterq të eperm dhe të ultë | 100,000.00 |
| 57 | Rregullimi i oborreve të tri QMF-ve | 24,000.00 |
| 58 | Rregullimi i oborreve dhe lyerja e 11 AMF-ve | 20,000.00 |
| 59 | Lyerja e objektit të QKMF-së | 20,000.00 |
| 60 | Blerja e zhvilluesit të RO | 20,000.00 |
| 61 | Ndertimi i garazhave për QKMF | 7,000.00 |
| 62 | Blerja e një autoambulance standard | 30,000.00 |
| 63 | Blerja e një autoambulance për hemodializë | 20,000.00 |
| 64 | Blerja e paisjeve për laborator në QKMF | 30,000.00 |
| 65 | Renovimi i aneksit të urgjencës në QKMF | 30,000.00 |
| 66 | Blerja e aparateve mjeksore për urgjencë në QKMF | 50,000.00 |
| 67 | Ndërtimi i AMF- ve në Perqevë dhe Kpuz | 50,000.00 |
| 68 | Zbatimi i digjitalizimit dhe kompjuterizimit të QKMF-së | 50,000.00 |
| 69 | Ndërtimi i shtepisë për persona të moshuar | 200,000.00 |
| 70 | Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve | 30,000.00 |
| 71 | Ndërtimi i objektit të zjarrëfikësve - faza e dytë | 150,000.00 |

| | | |
|---|---|---|
| 72 | Sinjalizimi i rrugëve | 260,000.00 |
| 73 | Mirëmbajtja e rrugëve | 500,000.00 |
| 74 | Mirëmbajtja e hapsirave publike | 100,000.00 |
| 75 | Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit | 100,000.00 |
| 76 | Mirëmbajtja e ndriqimit publik | 100,000.00 |
| 77 | Largimi i mbeturinave të ngurta | 60,000.00 |
| 78 | Furnizim me GPS | 13,000.00 |
| 79 | Ndërtimi i qendres rinore | 250,000.00 |
| 80 | Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Ismet Rraci" | 2,100,000.00 |
| 81 | Renovimi i objektit të shkollës së gjimnazit "Luigj Gurakuqi" | 70,000.00 |
| 82 | Renovimi i aneksit në SHFMU "Dëshmorët e Qëndresës", Gllarevë | 15,000.00 |
| 83 | Renovimi i objektit shkollor "Avni Zhabota", në Kerrnicë | 20,000.00 |
| 84 | Renovimi i objektit shkollor "Nënë Tereza", Budisalc | 15,000.00 |
| 85 | Ndërtimi i një aneksi 8 klasësh në SHFMU "Motrat Qiriazi", Klinë | 150,000.00 |
| 86 | Renovim i objektit në SHFMU "Azem Bejta", Grabanicë | 22,000.00 |
| 87 | Renovim i objektit në SHFMU "Dëshmorët e Kombit", Çabiq | 15,000.00 |
| 88 | Ndrrimi I kulmit në SHFMU " Atë Gjergj Fishta " , Jagodë | 20,000.00 |
| 89 | Ndërtimi i nxemjës qendrore në shkollat " Esat Mekuli " , "Ali Krasniqi" , "Azem Bejta", "Dëshmorët", "Avni Zhabota", "Nënë Tereza", "Atë Gjergj Fishta", "Motrat Qiriazi", "Isa Boletini" , "Zgjimi" dhe në puntorinë e SHMP "Fehmi Agani" . | 200,000.00 |
| 90 | Ndërtimi i nyjes sanitare në SHFMU "Dëshmort e Qëndresës", Gllarevë | 5,000.00 |
| 91 | Ndërtimi i tualeteve të brendshme në shkollat "Atë Gjergj Fishta", "Luigj Gurakuqi", "Dëshmorët", "Ali Krasniqi", "Dëshmorët e Kombit" | 55,000.00 |
| 92 | Ndërtimi i fushës së sportit në shkollat "Motrat Qiriazi", "Dëshmorët" , "Ymer Berisha", "Azem Bejta", "Tre Dëshmorët", "Avni Zhabota" , "Atë Gjergj Fishta", "Zgjimi" , "Ismet Rraci", "Motrat Qiriazi", "Atë Sh.Gjeçovi" , "Esad Mekuli", | 160,000.00 |
| 93 | Ndërtimi i depove për lëndë djegëse në shkolla | 170,000.00 |
| 94 | Furnizim me pajisje per shkolla | 220,000.00 |
| 95 | Furnizim me inventar ne shkolla | 50,000.00 |
| 96 | Ndërtimi i rrethojës së oborrit në shkollat "Ismet Rraci" , "Motrat Qiriazi", "Atë Gj.Fishta", "Azem Bejta", "Isa Boletini", "Nënë Tereza", "Tre Dëshmorët", "Dëshmorët e Qëndresës" dhe "Dëshmorët" | 190,000.00 |
| 97 | Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollat "Ali Krasniqi", "Esad Mekuli", "Zgjmi", "Nënë Tereza" , "Tre Dëshmorët" dhe "Atë Gj.Fishta" | 91,000.00 |
| 98 | Rregullimi i dyshemesë në shkollat "Emin Duraku", "Atë Gj.Fishta", | 50,000.00 |
| 99 | Rregullimi i oborrit të shkollës në SHFMU "Ymer Berisha", Siqevë | 5,000.00 |
| 100 | Gjelbrimi i oborreve të shkollave | 66,000.00 |
| 101 | Furnizim me lektyra shkollore dhe mjete didaktike në shkolla | 20,000.00 |
| 102 | Ndërtimi i kanalizimit dhe gropave skeptike në shkolla | 60,000.00 |
| 103 | Instalimi i kamerave në objektet shkollore | 27,000.00 |
| 104 | Ndërtimi i daljeve emergjente në shkolla | 45,000.00 |
| 105 | Rregullimi i shtratit të lumit Drini i bardhë | 1,250,000.00 |
| 106 | Pyllzimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe të degraduara | 50,000.00 |

| | | |
|---|---|---|
| 107 | Ndërtimi i shtëpive për të pa strehë | 200,000.00 |
| 108 | Ndërtimi i sistemit për pastrimin e ujrave të zeza | 1,500,000.00 |
| 109 | Digjitalizimi i lëndës arkivore | 10,000.00 |
| 110 | Furnizimi me aparaturë të nevojshme për kinema dhe teater profesional | 200,000.00 |
| 111 | Ndërtimi i teatrit veror | 30,000.00 |
| 112 | Ndërtimi i fushës ndihmëse të stadiumit | 20,000.00 |
| 113 | Ndërtimi i muzeut të qytetit | 200,000.00 |
| 114 | Ndërtimi i trotuareve në Klinavc | 20,000.00 |
| 115 | Asfaltimi i rrugës në Mahallë | 20,000.00 |
| 116 | Asfaltimi i rrugës Grabanicë- Dugujevë | 100,000.00 |
| 117 | Ndërtimi i pendës së ujitjës në Videjë | 50,000.00 |
| 118 | Kanalizimi në Videjë | 30,000.00 |
| 119 | Ndërtimi i trotuarit Klinë – Videjë – Jagodë | 30,000.00 |
| 120 | Formimi i fondit për financimin e NVM | |
| 121 | Formimi i shoqatës së bizneseve | |
| 122 | Ndërtimi i parkut të bizneseve | 500,000.00 |
| 123 | Trasimi i shtigjeve për këmbësor në Parkun Mirusha | 300,000.00 |
| 124 | Vendosja e teleferikut për në Parkun Mirusha | 1,000,000.00 |

# V. AMZA : NGA VIZIONI DERI TË PROJEKTET

| *Vizioni* | *Synimet* | *Objektivat* | *Programet* | *Projektet* |
|---|---|---|---|---|
| **Klina do të bëhet një vend ekonomikisht i zhvilluar,me një administratë komunale efikase në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe investuar.Duke patur për bazë pozitën dhe kushtet gjeografike ,prioritet do të jetë zhvillimi i bujqësisë,turizmit dhe infrastrukturës fizike.Do të kemi ngritje dhe përmirësim te cilësisë në arsim,shëndetësi dhe shërbime publike.** | **$S_1$: Zhvillimi ekonomik** | $S_1O_1$: Zhvillimi i NVM | $Pg_1$: Stimulimi dhe zhvillimi i bizneseve | $S_1O_1$ $Pg_1P_1$: Formimi i fondit për financimin e NVM |
| | | | | $S_1O_1$ $Pg_1P_2$: Formimi i shoqatës së bizneseve |
| | | | | $S_1O_1$ $Pg_1P_3$: Ndërtimi i parkut të bizneseve |
| | | $S_1O_2$: Zhvillimi i turizmit | $Pg_1$: Promovimi i turizmit | $S_1O_2$ $Pg_1P_1$: Trasimi i shtigjeve për këmbësor në Parkun Mirusha |
| | | | | $S_1O_2$ $Pg_1P_2$:Vendosja e teleferikut për në Parkun Mirusha |
| | | | | $S_1O_2$ $Pg_1P_3$:Ndërtimi i muzeut të qytetit |
| | | $S_1O_3$: Zhvillimi i bujqësisë | $Pg_1$: Programi për zhvillimin e bujqësisë,blegtorisë etj. | $S_1O_3Pg_1P_1$: Kanali i ujitjës në Zllakuqan- Radulloc |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_2$: Kanali i ujitjës në Këpuz |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_3$: Kanali i ujitjës në Grabanicë- Zajm |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_4$: Kanali i ujitjës në Jagodë |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_5$: Kanali i ujitjës në Dollovë |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_6$:Ndërtimi i serave |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_7$: Furnizim me fidane për pemë të imta(mjederr,dredhzë,manaferrë) |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_8$: Furnizim me mekanizem bujqësor si : autokombajë për zhveshje të misrit, motokultivator, mbjellëse për qepë etj. |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_9$: Furnizim me makina mjelëse |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_{10}$:Furnizim me koshere bletësh |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_{11}$:Ndërtimi i pikës grumbulluese të qumështit në Sferkë |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_{12}$:Ndërtimi i pendës në Drenoc |
| | | | | $S_1O_3Pg_1P_{13}$: Ndërtimi i pendës së ujitjës në Videjë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **S2: Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve.** | $S_2O_1$: Rritja e nivelit të shërbimeve administrative për qytetar dhe biznese (reduktimi i procedurave) | $Pg_1$: Infrastrukturë institucionale | $S_2O_1$ $Pg_1P_1$: Hartat zonale |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_2$: Ndërtimi i zyrës së gjendjës civile në Gllarevë |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_3$: Ndërtimi i zyrës së gjendjës civile në Ujmir |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_4$: Rregullimi i zyrës për kunorëzime |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_5$: Vendosja e një E-KIOSKU për shërbimet e gjendjës civile |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_6$: Avansimi i shërbimit të printimit në pay për print |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_7$: Lidhja në rrjetin fibër optik ndërmjet QK,QPS,QKMF,QKRC dhe ZP |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_8$: Përmirësimi i komunikimit të brendshëm me Sëitch Cisco POE +24 porta |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_9$: Ngritja e një qendre trajnuese për nevojat e administratës në fushen e TI |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_{10}$: Zhvillimi i një softveri për menagjimin e autoparkut |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_{11}$:Furnizim me GPS |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_{12}$:Ndërtimi i qendrës rinore |
| | | | | $S_2O_1$ $Pg_1P_{13}$:Ndërtimi i stacionit të autobusve |
| | | $S_2O_2$: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatra | $Pg_1$: Infrastrukturë fizike | $S_2O_2Pg_1P_1$: Ujësjellësi në Qabiq |
| | | | | $S_2O_2Pg_1P_2$:Ujësjellësi në Drenovc |
| | | $S_2O_3$: Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në fshatra | $Pg_1$: Infrastrukturë fizike | $S_2O_3Pg_1P_1$: Kanalizimi në Gjurgjevik të madh |
| | | | | $S_2O_3Pg_1P_2$: Kanalizimi në Zllakuqan |
| | | | | $S_2O_3$ $Pg_1P_3$: Kanalizimi në Dush të Sferkës |
| | | | | $S_2O_3Pg_1P_4$: Kanalizimi në Kërnicë |
| | | | | $S_2O_3$ $Pg_1P_5$: Kanalizimi në Zabergjë |
| | | | | $S_2O_3$ $Pg_1P_6$: Kanalizimi në Resnik |
| | | | | $S_2O_3Pg_1P_7$: Kanalizimi në Bokshiq |
| | | | | $S_2O_3$ $Pg_1P_8$: Kanalizimi në Gjurgjevik të vogël |
| | | | | $S_2O_3$ $Pg_1P_9$: Kanalizimi në Pataqan |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | $S_2O_3$ $Pg_1P_{10}$: Kanalizimi në Siqevë |
| | | | | $S_2O_3Pg_1P_{11}$: Kanalizimi në Jashanicë |
| | | | | $S_2O_3Pg_1P_{12}$: Kanalizimi në Radulloc |
| | | | | $S_2O_3Pg_1P_{13}$: Kanalizimi në Videjë |
| | | | | |
| | | $S_2O_4$:Përmirësimi i infrastrukturës rrugore | $Pg_1$: Infrastrukturë fizike | $S_2O_4Pg_1P_1$: Asfaltimi i rrugës në Krushevë të madhe |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_2$: Asfaltimi i rrugës në Jashanicë |
| | | | | $S_2O_4$ $Pg_1P_3$: Asfaltimi i rrugës në Deiq |
| | | | | $S_2O_4$ $Pg_1P_4$: Asfaltimi i rrugës në Shtupel |
| | | | | $S_2O_4$ $Pg_1P_5$: Asfaltimi i rrugës në Kpuz |
| | | | | $S_2O_4$ $Pg_1P_6$: Asfaltimi i rrugës në Zajm |
| | | | | $S_2O_4$ $Pg_1P_7$: Asfaltimi i rrugës në Stupë |
| | | | | $S_2O_4$ $Pg_1P_8$: Asfaltimi i rrugës në Qupevë |
| | | | | $S_2O_4$ $Pg_1P_9$: Asfaltimi i rrugës Jashanicë- Shtupel |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{10}$ : Asfaltimi i rrugës Stupë - Grabanicë |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{11}$: Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës transit Gremnik - Klinavc |
| | | | | $S_2O_4$ $Pg_1P_{12}$: Asfaltimi i rrugës Perqevë - Sferkë |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{13}$: Asfaltimi i rrugës në Pogragjë |
| | | | | $S_2O_4$ $Pg_1P_{14}$: Asfaltimi i rrugës Kpuz – Qeskovë |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{15}$: Asfaltimi i rrugëve të lagjeve të qytetit |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{16}$: Ndërtimi me gurë i sheshit –faza e dytë |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{17}$: Ndërtimi i trotuareve |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{18}$:Asfaltimi i rrugëve lokale në Poterq |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{19}$: Asfaltimi i rrugëve lokale në Drenoc |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{20}$: Ndërtimi i rrethrrotullimit të Sheshi Ndue |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Perlleshi |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{21}$:Ndërtimi i trotuareve në Klinavc |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{22}$:Asfaltimi i rrugës në Mahallë |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{23}$:Asfaltimi i rrugës Grabanicë- Dugujevë |
| | | | | $S_2O_4Pg_1P_{24}$:Ndërtimi i trotuarit Klinë – Videjë – Jagodë |
| | | | | |
| | | $S_2O_5$: Përmirësimi i infrastrukturës për shërbime publike | $Pg_1$: Infrastrukturë fizike | $S_2O_5Pg_1P_1$: Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve |
| | | | | $S_2O_5Pg_1P_2$: Ndërtimi i objektit të zjarrfikësve – faza e dytë |
| | | | | $S_2O_5Pg_1P_3$: Sinjalizimi i rrugëve |
| | | | | $S_2O_5Pg_1P_4$: Mirëmbajtja e rrugëve |
| | | | | $S_2O_5Pg_1P_5$:Mirëmbajtja e hapësirave publike |
| | | | | $S_2O_5Pg_1P_6$:Mirëmbajtja e ndriçimit publik |
| | **$S_3$: Arsimimi, mbrojtja sociale dhe shendetësore** | $S_3O1$: Përfshirja e gjithë fëmijëve në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor dhe përmirësimi i infrastrukturës shkollore | $Pg_1$: Infrastrukturë fizike | $S_3O_1Pg_1P_1$: Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Ismet Raci"- në Klinë |
| | | | | $S_3O_1Pg_1P_2$: Renovimi i objektit shkollor të gjimnazit "Luigj Gurakuqi " – në Klinë |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_3$: Renovimi i aneksit në SHMFU "Deshmorët e Qendresës " , Gllarevë |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_4$: Renovimi i objektit shkollor " Avni Zhabota " , Kernicë |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_5$: Renovimi i objektit shkollor në Budisalc |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_6$:Ndërtimi i një aneksi në SHFMU "Motrat Qiriazi " , Klinë |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_7$:Renovimi i objektit të SHFMU " Azem Bejta " , Grabanicë |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_8$: Renovimi i objektit të SHFMU " Deshmorët e Kombit " , Qabiq |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_9$: Ndrrimi I kulmit në SHFMU " Atë Gjergj Fishta " , Jagodë |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{10}$:Furnizim me paisje për shkolla |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{11}$: Furnizim me inventar për shkolla |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{12}$:Furnizim me lektyra shkollore dhe mjete didaktike për shkolla |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{13}$: Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollat "Ali Krasniqi", "Esad Mekuli", "Zgjmi", "Nënë Tereza" , "Tre Dëshmorët" dhe "Atë Gj.Fishta" |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{14}$: Ndërtimi i nxemjës qendrore në shkollat " Esat Mekuli " , "Ali Krasniqi" , "Azem Bejta", "Dëshmorët", "Avni Zhabota", "Nënë Tereza", "Atë Gjergj Fishta", "Motrat Qiriazi", "Isa Boletini" , "Zgjimi" dhe në puntorinë e SHMP "Fehmi Agani" . |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{15}$: Ndërtimi i rrethojës së oborrit në shkollat "Ismet Rraci" , "Motrat Qiriazi", "Atë Gj.Fishta", "Azem Bejta", "Isa Boletini", "Nënë Tereza", "Tre Dëshmorët", "Dëshmorët e Qëndresës" dhe "Dëshmorët" |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{16}$: Ndërtimi i fushës së sportit në shkollat "Motrat Qiriazi", "Dëshmorët" , "Ymer Berisha", "Azem Bejta", "Tre Dëshmorët", "Avni Zhabota" , "Atë Gjergj Fishta", "Zgjimi" , "Ismet Rraci", "Motrat Qiriazi", "Atë Sh.Gjeçovi" , "Esad Mekuli", |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{17}$: Ndërtimi i nyjes sanitare në SHFMU "Dëshmort e Qëndresës", Gllarevë |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{18}$: Ndërtimi i tualeteve të brendshme në shkollat "Atë Gjergj Fishta", "Luigj Gurakuqi", "Dëshmorët", "Ali Krasniqi", "Dëshmorët e Kombit" |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{19}$: Ndërtimi i depove për lëndë djegëse në shkolla |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{20}$: Rregullimi i dyshemesë në shkollat "Emin Duraku" dhe "Atë Gj.Fishta" |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{21}$: Rregullimi i oborrit të shkollës në SHFMU "Ymer Berisha", Siqevë |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{22}$: Gjelbrimi i oborreve të shkollave |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{23}$: Ndërtimi i kanalizimit dhe gropave skeptike në shkolla |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{24}$: Instalimi i kamerave në objektet shkollore |
| | | | | $S_3O_1$ $Pg_1P_{25}$: Ndërtimi i daljeve emergjente në shkolla |
| | | $S_3O_2$: Ngritja e nivelit të shërbimeve dhe përmirësimi i infrastrukturës shendetësore në QKMF, në QMF dhe AMF | $Pg_1$: Infrastrukturë fizike | $S_3O_2Pg_1P_1$: Blerja e zhvilluesit të RO |
| | | | | $S_3O_2Pg_1P_2$: Blerja e një autoambulance standard |
| | | | | $S_3O_2Pg_1P_3$: Blerja e një autoambulance për hemodializë |
| | | | | $S_3O_2Pg_1P_4$: Blerja e paisjeve për laborator në QKMF |
| | | | | $S_3O_2Pg_1P_5$: Blerja e aparateve mjeksore për urgjencë në QKMF |
| | | | | $S_3O_2Pg_1P_6$: Renovimi i aneksit të urgjencës në QKMF |
| | | | | $S_3O_2$ $Pg_1P_7$: Lyerja e objektit të QKMF-së |
| | | | | $S_3O_2Pg_1P_8$: Rregullimi i oborreve dhe lyerja e 11 AMF-ve |
| | | | | $S_3O_2Pg_1P_9$: Rregullimi i oborreve të 3 QMF-ve |
| | | | | $S_3O_2Pg_1P_{10}$: Ndërtimi i garazheve për QKMF |
| | | | | $S_3O_2Pg_1P_{11}$: Ndërtimi i AMF- ve në Perqevë dhe Kpuz |
| | | | | $S_3O_2Pg_1P_{12}$: Zbatimi i digjitalizimit dhe kompjuterizimit të QKMF-së |
| | | $S_3O_3$: Përkrahja e të pa strehëve , të moshuarve dhe personave pa familje | $Pg_1$: Infrastrukturë fizike | $S_3O_3Pg_1P_1$: Ndërtimi i shtëpive për të pa strehë |
| | | | | $S_3O_3Pg_1P_2$: Ndërtimi i shtepisë për persona të moshuar |
| | **$S_4$: Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor** | $S_4O_1$: Ulja graduale e ndotjës së ujit, ajrit, tokës etj. | Pg0. Politikat lokale mjedisore dhe legjislacioni | Rishikimi i PLVM 2010-2015<br>Hartimi i PLVM 2017-2021<br>Futja e prioriteve te PLVM ne ZHEL 2017-21<br>Themelimi i nje Qenndre per Edukim Mjedisor (parapar edhe me projektin e Keshillit te Evropes) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | $Pg_1$: Zgjerimim dhe permirsim i Infrastrukturës fizike ne sherbim te permirsimit et cilesise se jetes | $S_4O_1$ $Pg_1P_1$: Pastrimi i ambientit ngavendgrumbullimet ilegale te mbeturinave te e ngurta |
| | | | | $S_4O_1$ $Pg_1P_2$: Mirëmbajtja e infrastruktures rrugore, kanalizimit, parqeve, ujësjellësit, pastrimi i deborës |
| | | | | $S_4O_1Pg_1P_3$: Zgjerimi i sistemit te ujesjellsit per uje te pijes ne xx fshtra<br>$S_4O_1Pg_1P_3$: Zgjerimi i sistemit te kanalizimit ne xx fshatra |
| | | | | $S_4O_1Pg_1P_4$:Projektimi dhe nërtimi i impiantit për pastrimin e ujrave të zeza |
| | | $S_4O_2$:Ruajtja dhe përmirësimi i natyrës | $Pg_1$: Mbrojtja, ri-pertrirja dhe promovimi i vlerave natyrore te komunes | $S_4O_2Pg_1P_1$: Pyllezimi i sipërfaqeve të zhveshura dhe të degraduara |
| | | | | $S_4O_2Pg_1P_2$ Rikthimi i zonave te operimit te gurethyesve ne kushtet e parapara me pelqiemt mjedisore |
| | | | | Promovimi i zonave eko-turistike: Kanjoni i Mirushes, Shpella e Dushit dhe Gryka e Lumit Klina |
| | | | | $S_4O_2Pg_1$P4Trajtimi i dhe mirembajtja e vegjetacioni te ekosistemit lumor te Lumit Klina te pjesa ku eshte rregulluar shtrati |
| | | | | $S_4O_2$ $Pg_1P_5$: Rregullimi i shtratit të lumit Drini i bardhë |

**Klinë, me 29.06.2017**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Dr.Haxhi Ibishi**